

EKONOMI DHE FINANCË

SHTEGU I NGUSHTË I ZHVILLIMIT

Koha për politika industriale

Irena Beqiraj
Knidi Bashari
Nëntor 2021



Politikat industriale sot duhet të trajtojnë nevojën për të ushqyer dhe për të zhvilluar aktivitete të sofistikuara ekonomike, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm te prodhimi.



Arsyeja e ngushtimit të shtegut të zhvillimit ekonomik shqiptar është mungesa e aftësive për inovacion.



Për të shpëtuar nga kurthi i të ardhurave të mesme ku ka rënë ekonomia vendase, Shqipërisë i duhet të ndryshojë qasjen strategjike të zhvillimit.

EKONOMI DHE FINANCË

SHTEGU I NGUSHTË I ZHVILLIMIT

Koha për politika industriale



Programi «Economy for All» është një iniciativë e Fondacionit «Friedrich Ebert» që synon të ridimensionojë rolin e aktorëve ekonomikë dhe shoqërorë për të hedhur bazat e krijimit të një modeli të ri social-ekonomik. Iniciativa e FES-it mbështetet plotësisht në ekspertizën e anëtarëve të grupit të ekspertëve, të cilët gjithashtu kanë reflektuar mbi studimin që ju tashmë keni në dorë.

FES-i falënderon grupin e punës të këtij programi, të përbërë nga: Adrian Civici, Daniel Guçe, Irena Beqiraj, Knidi Bashari, Ornela Liperi dhe Selami Xhepa, për angazhimin e plotë dhe vullnetin e mirë për një investim serioz drejt një modeli social-ekonomik për vendin tonë.

Përmbajtja

1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
2.	HYRJE	9
3.	RRUGA DREJT RITJES SË QËNDRUESHME	11
3.1.	Korniza teorike e kurthit të të ardhurave të mesme	11
	3.1.1. Institucionet.....	12
	3.1.2. Tregtia, struktura industriale dhe hapja	12
4.	SHTEGU I NGUSHTË I ZHVILLIMIT TË SHQIPËRISË ...	16
4.1.	Statusi aktual i zhvillimit.....	16
	4.1.1. Një përmbledhje e shkurtër.....	16
4.2.	Modeli ekonomik nuk e mbështet rritjen e produktivitetit.....	17
	4.2.1. Njohuritë produktive. Dështimi i aftësive.....	19
	4.2.2. Struktura e ndërmarrjes. Dështimi i madhësisë së biznesit..	23
5.	NJË POLITIKË INDUSTRIALE PËR SHQIPËRINË	26
5.1.	Politika industriale ka të bëjë me prodhimin dhe shërbimet e sofistikuara	26
5.2.	Nga t'ia fillojmë?.....	30
6.	VËREJTJET E FUNDIT	35
7.	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	36
	BIBLIOGRAFIA	37

Figurat

Figura 1:	Vlera e shtuar për punëtor dhe TFP-ja	13
Figura 2:	Krijimi i vendeve të punës neto nga statusi eksportues i firmave prodhuese	14
Figura 3:	Vlera e shtuar për punëtor (krahasuar me BE 28-n).....	17
Figura 4:	Faktori total i produktivitetit kundrejt vlerës së shtuar për punonjës në shërbimet e prodhimit	18
Figura 5:	Pjesa e punësimit sipas intensitetit të përdorimit të teknologjisë 2016	18
Figura 6:	Rritja e PBB-së së Shqipërisë krahasuar me Greqinë, Italinë dhe Ballkanin Perëndimor	20
Figura 7:	Reflektime të aftësisë së ulët të firmave shqiptare: mosha e firmës; përvoja e menaxherit; përdorimi i postës elektronike dhe pasqyrat financiare të rishikuara nga auditorët e jashtëm.....	21
Figura 8:	Eksportet e Shqipërisë si përqindje e PBB-së dhe përqindja e firmave shqiptare që eksportojnë	21
Figura 9:	Kompleksiteti Ekonomik kundrejt PBB-së për frymë, 2014.....	22
Figura 10:	Madhësia mesatare e firmës sipas sektorëve, 2016.....	24
Figura 11:	Struktura ekonomike sipas sektorëve në përqindje, 2010–2018	27
Figura 12:	Eksportet e Shqipërisë në vitet 2016–2020	28
Figura 13:	Ndikimi i turizmit në eksporte, 2000–2015	29

Tabelat

Tabela 1:	Struktura e ndërmarrjeve nga punësimi	23
Tabela 2:	Struktura e ndërmarrjeve sipas qarkullimit, investimeve dhe vlerës së shtuar	24
Tabela 3:	Numri i produkteve premtuese sipas kategorive të produkteve në Shqipëri (2016).....	31

Akronimet

ADB	Banka Aziatike për Zhvillim
ALB	Albania
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Europian
BM	Biznese të mëdha
CID	Qendra për Zhvillim Ndërkombëtar pranë Universitetit të Harvardit
DLT	Teknologjia e Regjistrimit të Shpërndarë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GVC	Zinxhiri Global i Vlerës
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IKE	Indeksi i Kompleksitetit Ekonomik
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti i Statistikës
IoE	Interneti i Gjithçkaje
IoT	Interneti i Objekteve
IPR	Pronësia Intelektuale
KAM	Kurthi i të ardhurave të mesme
K&ZH	Kërkim-Zhvillim
MNC	Korporata Shumëkombëshe
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OEM	Prodhuesi Origjinal i Pajisjeve
OG	Përfitimi Oportun
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
RCA	Avantazh Krahasues i Dukshëm
SKI	Sistemi Kombëtar i Inovacionit
TAP	Gazsjellësi TransAdriatik
TFP	Faktori Total i Produktivitetit
UNCTAD	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim
UNIDO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial

1

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria ka përparuar nga vendi më i varfër në Europë në fillim të viteve 1990, në vend me të ardhura të mesme, status të cilin e arriti në vitin 2008. Në fazën aktuale të zhvillimit vihet re që rritja ekonomike është ngadalësuar, produktiviteti ka pësuar ulje, ndërsa përfitimet si rrjedhojë e krahut të lirë të punës dhe imitimit të teknologjisë së huaj janë zvogëluar. Produktet shqiptare janë me vlerë të shtuar të ulët dhe ekonomia vendase ka mangësi në krijimin e vendeve të punës cilësore dhe mbajtjen e ritmit të rritjes së eksporteve. Rritja e eksporteve shqiptare bazohet në konkurrencën e çmimeve, e cila mbështetet te nënvlerësimi i monedhës vendase ose te pagat e ulëta. Eksperienca shqiptare vërteton faktin që pasi arrihet statusi i vendit me të ardhura të mesme, shtegu i transformimit në vend me të ardhura të larta ngushtohet së tepërmi. I ashtuquajtur "Konsensus i Uashingtonit", i cili ka qenë modeli universal i rritjes që prej 1980-s, rezulton jo i mjaftueshëm për të mbështetur rritjen e nevojshme afatgjatë. Ky fenomen nuk është aspak unik. Që prej viteve 1960, 88 vende në zhvillim kanë rënë në "kurthin e të ardhurave të mesme", një situatë ku ekonomia tenton të ngadalësojë rritjen, ngadalësim i cili vjen si rezultat i inovacionit të dobët. Aftësia e inovacionit është vërtetuar të jetë përcaktuesi kryesor i zhvillimit për një vend që ka arritur stadin e vendit me të ardhura të mesme. Analistë të rritjes ekonomike arsyetojnë që: ekonomitë e suksesshme janë mbështetur gjithmonë te "dora drejtuese e Shtetit" për të promovuar inovacionin dhe për të përmirësuar produktivitetin. Prandaj dhe kur gërvishim sipërfaqen e çdo industrie të re të suksesshme kudo në botë, do të gjejmë ndihmën e qeverisë që fshihet nën të. Pra, çfarë i nevojitet Shqipërisë, janë politika të cilat synojnë të rritin produktivitetin e ekonomisë, duke i dhënë asaj virtytin që i mungon, "aftësinë për inovacion". Disa ekonomistë preferojnë t'i quajnë politika të zhvillimit të produktivitetit, por, në fund të fundit, ato janë as më shumë e as më pak politika industriale.

Nuk ka një shkencë të gjithëpranuar për produktivitetin. Për këtë arsye, nuk ka asnjë recetë të gjithëpranuar për një politikë industriale moderne. Veçanërisht për një vend ish-socialist, ku politika industriale lidhet me ekonominë e centralizuar dhe diktaturën, ky emërtim mund të konsiderohet një togfjalësh toksik. Për këtë arsye, në rastin e Shqipërisë, politikat industriale nuk janë të lehta për t'u

pranuar, janë të vështira për t'u hartuar dhe sfiduese për t'u zbatuar. Politika industriale e shekullit XXI nuk është planifikim i centralizuar, por e kundërta e tij, pasi favorizon më shumë, jo më pak konkurrencë dhe autonomi në sektorin privat. Nuk është politikëbërje standarde nga lart-poshtë, e cila orientohet drejt sektorëve të parazgjedhur, duke përdorur një listë standarde të subvencioneve dhe stimujve. Aq më tepër në vende si Shqipëria, ku vërehen dështime komplekse, si (i) dështimi i aftësive, që përfshin dështimin e tregut, dështimin e sistemit dhe dështimin e të mësuarit, apo (ii) dështimi i madhësisë së biznesit, politika industriale duhet të jetë shumë më pak e prirë drejt stimujve nga lart-poshtë dhe shumë më tepër e orientuar drejt krijimit të një bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe joselektiv midis sektorit publik dhe atij privat për sa u përket çështjeve të produktivitetit. Si e tillë, ajo është e kundërta e mbështetjes së papërcaktuar për firmat me performancë të ulët inovative.

Ndër të tjera, politika industriale nuk duhet të fokusohet vetëm te prodhimi. Ndërsa ekonomia botërore kthehet gjithnjë e më shumë drejt shërbimeve, çfarë nevojitet është një politikë industriale që trajton nevojën për të ushqyer dhe për të zhvilluar aktivitete të sofistikuar ekonomike, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm te prodhimi.

Për të përmirësuar strukturën e përgjithshme industriale të vendit, politika industriale duhet të përqendrohet në dy lloje përmirësimesh: hyrja në industri të reja dhe përmirësimi i segmenteve me vlerë të lartë në industritë ekzistuese. Identifikimi i sektorëve që do të përmirësonin strukturën industriale të vendit, është proces delikat, që kërkon studim të të dhënave, por edhe largpamësi. Për një ekonomi të vogël është e rëndësishme të identifikohen produktet dhe sektorët që (i) janë në përputhje me strukturat aktuale dhe avantazhin konkurrues dhe (ii) produktet apo sektorët që po rriten në mënyrë dinamike në të gjithë globin për shkak të tendencave aktuale dhe të ardhshme të konsumit. E para, nënkupton analizën e anës së ofertës, ose cilat janë kompetencat kryesore të vendit, dhe e dyta përfaqëson analizën në kahun e kërkesës. Një kriter tjetër i rëndësishëm që duhet marrë parasysh për identifikimin e sektorëve lidhet me madhësinë e barrierave të hyrjes në tregjet globale. Për këtë arsye, sektorët e bazuar në burime piren të shoqërohen me

barriera të ulëta hyrëse. Po ashtu, sektorët/segmentet me cikël të shkurtër teknologjik kanë barriera të ulëta hyrëse, sepse shoqërohen me pak përplasje me teknologjitë e vendeve të përparuara, me më pak pagesa të pronësisë intelektuale, si dhe me avantazhin e hyrjes së shpejtë dhe me diferencimin e produktit. Së dyti, për të rritur produktivitetin, është e nevojshme t'u sigurojmë firmave vendase mundësi për të mësuar, në mënyrë që ato të rritin aftësitë e tyre inovative. Zhvillimi i SKI-ve rrit mundësinë për inovacion dhe performancë ekonomike në vendet me të ardhura të mesme. Ngritja e aftësive për firmat vendase duhet të plotësohet me tri elemente: (i) hartimin e sistemeve të inovacionit rreth sektorëve, (ii) ekzistencën e mjediseve të nevojshme institucionale, (iii) krijimin e lidhjeve dhe të ndërveprimit të nevojshëm midis aktorëve që përbëjnë sistemin.

Elementi i tretë është ofrimi i stimujve dhe financimi për shpenzimet e kërkim-zhvillimit. Zhvillimi i suksesshëm teknologjik kërkon: mbështetjen e qeverisë për të mundësuar aksesin në njohuritë e huaja, financimin dhe kompensimin e firmave pioniere në industritë e identifikuar me stimuj të kufizuar në kohë, bashkëfinancimin e

investimeve, ose sigurim të kapitalit të huaj apo vendas. Ky punim përbëhet nga pesë kapituj. Në kapitullin hyrës jemi përpjekur të shpjegojmë përse politika industriale ka dalë sërish në skenë, megjithëse eksperiencia e vendeve të zhvilluara tregon se, edhe pse është anashkaluar, ajo nuk ka qenë kurrë jashtë skene. Në kapitullin e dytë jemi përpjekur të analizojmë rrugën e ndjekur drejt rritjes së qëndrueshme dhe përse vendet në zhvillim ngecin në kurthin e të ardhurave të mesme, cilët janë faktorët që drejtojnë rritjen në këtë fazë dhe cili është variabli kryesor i rritjes afatgjatë që mundëson kalimin në shtegun e ngushtuar tanimë të zhvillimit. Kapitulli i tretë i dedikohet tërësisht ekzaminimit të karakteristikave të ekonomisë shqiptare, duke vënë theksin te dy dështimet kryesore të saj: dështimin për të krijuar aftësi inovative në nivel firme, si dhe mungesën e ekonomisë së shkallës, apo dështimin strukturor të madhësisë së biznesit. Duke u mbështetur në këtë diagnostikim, kemi analizuar dhe përcaktuar cilët janë përbërësit e një politike industriale të suksesshme për Shqipërinë, për të përfunduar me disa konsiderata të fundit se si një politikë industriale duhet t'i përshtatet kornizës së gjerë të politikëbërjes.

2

HYRJE

Në punimin e tyre "Rilindja e politikave industriale dhe një agjendë për shekullin XXI", Karl Aiginger dhe Dani Rodrik shprehen se: "politika industriale është përsëri në skenë, pas një periudhe të rënies së interesit dhe parashikimeve për vdekjen e parakohshme së saj". Në fakt, politika industriale ka qenë prej kohësh një nga temat më të diskutuara në ekonomi. Pjesa më e madhe e ekonomistëve neoklasikë e kanë refuzuar me maturi idenë e tyre. Sipas pretendimit të nobelistit Gary Becker, "Politika më e mirë industriale është të mos kesh fare një të tillë" (1985). John Williamson, një ndër promovuesit e "Konsensusit të Uashingtonit" si modeli më i përshtatshëm i zhvillimit, do të shprehej se "Sipas të dhënave të politikave industriale, shteti rezulton shumë i dobët në zgjedhjen e fituesve" (2012). Lawrence Summers (ish-kryeekonomist i Bankës Botërore dhe Sekretar amerikan i Thesarit, aktualisht profesor i ekonomisë në Harvard) thotë se, "qeveria është një sipërmarrje kapitaliste e keqe" (cituar në "Nocera", 2011). Revista "The Economist" shkruan: "Qeveria ka një reputacion të tmerrshëm në zgjedhjen e fituesve" (2011). William Easterly (ish-ekonomist i Bankës Botërore, aktualisht profesor i ekonomisë në Universitetin e Nju-Jorkut) hodhi poshtë efektivitetin e politikës industriale të Azisë Lindore, duke thënë: "Të dhënat e diktatorëve që zgjedhin fituesit janë shumë të dobëta, kështu që pse jemi kaq të sigurt se ky faktor kontribuoi në suksesin e tigrave të Azisë Lindore?" (2009). Këta dhe ekonomistë të tjerë neoklasikë duket se konvergojnë në një tezë të vetme: "politika industriale" konsiston "në zgjedhjen e fituesit nga qeveria", dhe të gjithë e dinë se qeveritë nuk mund të zgjedhin në mënyrë të drejtë.

Sidoqoftë, kohët e fundit, dhe veçanërisht që pas Recesionit të Madh të vitit 2008, politika industriale ka filluar të rilindë. Ajo është kthyer sërish në qendër të vëmendjes, falë punimeve të ndryshme nga ekonomistë të shquar të zhvillimit (duke përfshirë Dani Rodrik-un, Ricardo Hausmann-in, Ha-Joon Chang-un, Joseph Stiglitz-in, Mariana Mazzucato-n dhe Justin Yifu Lin-in). OECD-ja publikoi raportin kryesor me temë "Perspektivat mbi zhvillimin global 2013: Politikat industriale në një botë në ndryshim" (2013). UNCTAD-i dhe ILO-ja publikuan "Transformimi i ekonomive: Vendosja e politikave industriale në shërbim të rritjes, punës dhe zhvillimit" (2014, redaktuar nga J. Salazar-Xirinachs). Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO)

ka si aktivitet kryesor zhvillimin industrial gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe organizon aktivitete promovuese të politikave industriale. Ndërkohë që libri i Mariana Mazzucato-s, "Marrëdhënia e Shtetit si sipërmarrës: Zhbërja e mitit të sektorit publik kundrejt sektorit privat" (2013) u bë një nga librat më të shitur, i përkthyer në gjashtë gjuhë europiane deri më tani, duke kryesuar listën e librave kushtuar politikave ekonomike në "Amazon".

Arsyet që kanë kontribuar në këtë ripërtëritje janë të shumta, por ajo që vlen të përmendet është se çdo ditë e më shumë po provohet se nuk ka një model universal ekonomik që siguron rritje ekonomike të qëndrueshme, i cili të jetë i vlefshëm në çdo fazë zhvillimi të çdo vendi, pavarësisht nga struktura ekonomike e tij.

"Një sërë tendencash kanë kontribuar në ripërtëritjen e interesit për politikën industriale. Në mënyrë të veçantë, në vendet në zhvillim ka pasur një prapësim dhe dyshime mbi qasjen fundamentaliste të tregut, të cilat lidhen me Konsensusin e Uashingtonit. Edhe kur normat e rritjes kanë qenë të larta, ekonomitë në zhvillim kanë përjetuar paqëndrueshmëri në rritje, norma të pakënaqshme të transformimit produktiv dhe mangësi në krijimin e vendeve të punës cilësore në prodhim ose shërbime moderne. Ekziston një lidhje statistikore e stabilizuar në një ekonomi, midis rritjes së prodhimit dhe shtimit të të ardhurave kombëtare. Ekonomitë me rritje të shpejtë kanë tendencë të kenë një rritje relativisht të shpejtë prodhimi dhe anasjellas, ekonomitë me rritje të ngadaltë kanë tendencë të kenë një rritje të ngadaltë prodhimi. Kjo marrëdhënie nuk haset në bujqësi, ku normalisht nuk ka lidhje të qëndrueshme midis rritjes së sektorit bujqësor dhe shtimit të të ardhurave kombëtare. Shërbimet jo të sofistikuar, nga ana tjetër, kanë tendencë të rriten në përputhje me të ardhurat kombëtare, por roli i tyre shihet si pasiv në rritjet ekonomike krahasuar me ndikimin e rritjes në aktivitetin prodhues. Kjo situatë ka krijuar një kërkesë për politika proaktive të qeverisë për t'i diversifikuar dhe përmirësuar ekonomitë përtej thjesht liritimit të tregjeve" (Aiginger, K., Rodrik, D, 2019)¹.

¹ Aiginger, K., Rodrik, D. Rilindja e politikës industriale dhe një agjendë për shekullin XXI. Ind Compet Trade 20, 189-207 (2020).

“Pa anashkaluar vendimmarrjet autonome të bazuara në sinjalet e tregut nga sektori privat, të cilat janë vendimtare, sot po pranohet gjithmonë edhe më shumë se “dora drejtuese e Shtetit” ka një rol të rëndësishëm në alokimin e kapitalit dhe punës, duke e drejtuar atë në aktivitete të cilat tregu jo domosdoshmërisht do t’i ndërmerre” (Cherif, Hasanov dhe Kammer, 2016).

Sipas Cherif-it, Hasanov-it dhe Chami-it në punimin e tyre “Kthimi i politikës që nuk duhet emërtuar: Parimet e politikës industriale”, theksohet se: “receta standarde e rritjes, e cila bazohet te përmirësimi i mjedisit të biznesit, i institucioneve dhe infrastrukturës, te ruajtja e stabilitetit makro, tek investimi në arsim dhe te minimizimi i ndërhyrjeve të qeverisë, nuk është e mjaftueshme për të mbështetur rritjen e lartë në plan afatgjatë. Ajo përfaqëson marshin më të ulët të politikës industriale, ose qasjen e “zvarritjes së kërmillit”. Këto politika kryesisht tentojnë të rregullojnë “dështimet e qeverisë”, por jo doemos dështimet e tregut, veçanërisht në zhvillimin e sektorëve të sofistikuar. Politikat që synojnë të tërheqin IHD-të, të shoqëruara me ndërhyrjen shtetërore për t’i zhvilluar industritë rreth sektorëve ku vendi ka apo mund të krijojë një avantazh krahasues, bëjnë të mundur kalimin në një marsh tjetër, atë të “kërcimit të shpejtë”, i cili ushqen rritjen e qëndrueshme. Por nëse shteti merr përsipër të zhvillojë sektorë të sofistikuar dhe teknologji vendase, atëherë ai do të krijonte kushte për rritje të lartë dhe të qëndrueshme afatgjatë. Këto politika ambicioze, të ndjekura nga mrekullitë aziatike, përfaqësojnë qasjen e krahasuar me “udhëtimin në hënë” (FMN, Reda Cherif dhe Fuad Hasanov, 2019)².

Por cila do të ishte një strategji që mund të prodhonte industrializim të shpejtë, pavarësisht nga forcat që shtyjnë në drejtime të tjera, siç janë shfrytëzimi pa kriter i pasurive natyrore apo ndikimet në ndryshimet klimatike? Disa nga pyetjet që shtrohen sot në studimet ekonomike janë: A ka ndonjë rrugë për të kapërcyer deindustrializimin e parakohshëm në Shqipëri, i cili lidhet me rënien e prodhimit industrial të reflektuar në mbylljen e fabrikave dhe uzinave pas vitit 1990, me kurthin e të ardhurave të mesme, me pamundësinë për të krijuar aftësi dhe fragmentarizimin e sipërmarrjes për t’u transformuar në një ekonomi më konkurruese dhe me të diversifikuar? Si duhet t’i përgjigjen

politikat zhvilluese ndryshimit të shpejtë teknologjik të shekullit XXI? Si mund të hartojnë politikëbërësit shqiptarë një politikë industriale të orientuar nga e ardhmja dhe mirëqenia, e cila trajton jo vetëm dështimet e tregut, por edhe sfidat më të rëndësishme shoqërore dhe mjedisore të shoqërisë?

Në këtë punim, jemi përpjekur të japim një përkufizim të përgjithshëm të politikës industriale, duke bërë të kundërtën, pra, duke u përpjekur të shpjegojmë çfarë ajo nuk duhet të jetë. Disa autorë, duke përfshirë Dani Rodrikun, M. Mazzucato-n, dhe Keun Lee-në etj., kanë shtjelluar pyetje që lidhen me rolin e shtetit në politikat industriale. Për sa i përket rolit të shtetit, politika industriale që na nevojitet nuk është një planifikim i centralizuar, por e kundërta e tij, ajo duhet të favorizojë më shumë dhe jo më pak konkurrencën dhe autonominë e sektorit privat. Roli i shtetit nuk duhet të jetë thjesht për të korrigjuar “dështimet e tregut”, por edhe për të zbatuar një disiplinë të rreptë të tij. Si e tillë, politika industriale që na duhet është e kundërta e mbështetjes së pakushtëzuar për firmat me performancë të ulët dhe që operojnë kryesisht si “kërkuese qiraje” (nga ang., *rent seekers*).

Ne besojmë se politika industriale nuk është e lehtë për t’u hartuar dhe zbatuar, pasi nuk ka asnjë recetë të gatshme që mund të ndiqet. Përgjigjja më e drejte për çdo pyetje që lidhet me politikat ekonomike është: “Varet.” Përzgjedhja e sektorëve se ku duhet të përqendrohemi nuk është objekt i këtij studimi. Mënyra e zgjedhjes së sektorëve dhe zbatimi i një discipline të rreptë të tregut janë ende një territor i panjohur, por përbëjnë një hapësirë të rëndësishme për t’u eksploruar. Për më tepër, vlen të theksohet se politika industriale nuk është në kundërshtim me recetën standarde të makro stabilitetit, përmirësimin të institucioneve dhe mjedisit të biznesit, apo investimit në infrastrukturë dhe kapital njerëzor. Të gjithë këta përbërës janë të nevojshëm, por nuk mjaftojnë për një rritje të qëndrueshme afatgjatë. Tashmë ka ardhur koha që të mendojmë në shkallë të gjerë. Në hartimin e politikave industriale, Shqipëria duhet të ndjekë strategji që marrin parasysh jo vetëm rrethanat e saj specifike, por edhe ndryshimet në kontekstin global. Kjo nënkupton trajtimin e pyetjeve, si: cilët janë sektorët specifikë ku duhet të përqendrohemi, çfarë lloj institucionesh duhen ndërtuar në mbështetje të këtyre sektorëve, çfarë lloj aftësish dhe infrastrukture na duhen dhe si ta realizojmë këtë?

2 Kthimi i politikës që nuk duhet emërtuar: Parimet e politikës industriale: Reda Cherif dhe Fuad Hasanov – Vëllimi:2019/074 Fondi Monetari Ndërkombëtar DOI: <https://doi.org/10.5089/9781498305402.001>

3

RRUGA DREJT RITJES SË QËNDRUESHME

“Ndërsa rritja e mirëqenies së njerëzimit është një çështje jetike, mënyra e arritjes së rritjes së qëndrueshme ekonomike mbetet e panjohur dhe ka qenë një temë e gjatë në kërkimin ekonomik”³ (North, 2005). Studimet mbi rritjen ekonomike përqipen të gjejnë një model universal për rritjen ekonomike që funksionon për të gjitha vendet në të gjitha fazat, pavarësisht nga niveli i të ardhurave dhe nga dallimet strukturore të tyre. Ky vëzhgim nuk është befalues, duke pasur parasysh se në ekonomi gjithmonë përqipemi të gjejmë faktorët “e përgjithshëm” dhe jo faktorët “specifikë” që ndikojnë te rritja ekonomike. Për shembull, modeli ekzistues ekonomik bazohet në funksionin e thjeshtë të prodhimit ndaj dy variablave, fuqisë punëtore dhe kapitalit si faktorët kryesorë të tij, ndërkohë që elasticiteti i tyre dhe teknologjitë e lidhura me të supozohen të jenë të njëjta në të gjitha vendet. Në këtë model të vjetër rritjeje, i cili merr në konsideratë hendekun në akumulimin e kapitalit, arritjet e vendeve në zhvillim trajtohen si çështje të akumulimit të shpejtë të kapitalit, pa marrë parasysh teknologjitë e ndryshme.

Në përputhje me sa parashtruam më sipër, Shqipëria ka tentuar ta sigurojë rritjen ekonomike duke kopjuar praktikën dhe institucionet e ekonomive të përparuara. Modeli ekonomik i ndjekur, i ashtuquajtur “Konsensus i Uashingtonit”, promovon paketa politikash me ndërhyrje minimale të qeverisë, privatizim të pronës shtetërore, liberalizim të tregtisë dhe të tregjeve financiare, promovon investimet e huaja direkte (IHD) nga korporata shumëkombëshe (SHA), promovim ky që ka dominuar edhe mbi promovimin e kompanive kombëtare dhe të drejtat e forta të pronësisë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh performancën e tij të dobët, modeli i rritjes i bazuar mbi Konsensusin e Uashingtonit u shpall “i vdekur” nga Dani Rodrik-u, i cili bëri thirrje për kërkimin e alternativave të tjera të zhvillimit (Rodrik, 2006)⁴.

Në fakt, ka disa studime empirike të cilat sugjerojnë se ekonomitë e përparuara dhe ekonomitë në zhvillim kanë

mekanizma të ndryshëm rritjeje, dhe transformimi i këtyre të fundit në ekonomi të përparuara është i vështirë.

Në fillim të viteve 1990, Shqipëria ishte vendi më i varfër në Europë. Stadi i një vendi me të ardhura të mesme u arrit në vitin 2008. Nëse rritja ekonomike në stadin e vendit me të ardhura më të ulëta ishte e lidhur me institucionet themelore politike dhe kapitalin bazë njerëzor, sigurimi i rritjes ekonomike në stadin e vendit me të ardhura të mesme u bë edhe më i vështirë. Shqipëria nuk është as e pari e as i fundit vend në zhvillim që ka ka rënë në kurthin e vendeve me të ardhura të mesme, ose në një situatë ku ekonomia tenton të përballet me një rritje të ngadalësuar dhe, për pasojë, nuk arrin t’u bashkohet ekonomive me të ardhura të larta.

Sipas studimeve të Bankës Botërore, vetëm dymbëdhjetë nga njëqind e një ekonomi me të ardhura të mesme i janë bashkuar klubit të ekonomive me të ardhura të larta që nga viti 1960. Midis këtyre vendeve, nëntë janë raportuar të jenë ekonomi me të ardhura të mesme të larta (20% deri në 40% të të ardhurave për frymë të SHBA-së, duke përfshirë Greqinë, Portugalinë, Spanjën, Irlandën, Hong Kongun, Izraelin, Japoninë, ishullin Mauricium, Porto Rikon dhe Singaporin). Vetëm dy raportuan se ishin vende me të ardhura të ulëta (përkatesisht Koreja dhe Tajvani), dhe njëri ishte vend eksportues i naftës (Guineja Ekuatoriale)⁵.

3.1. KORNIZA TEORIKE E KURTHIT TË TË ARDHURAVE TË MESME

Ekzistenca e “kurthit të të ardhurave të mesme” (KAM) u përmend për herë të parë nga Gill-i dhe Kharas-i⁶ (2007), dhe që atëherë ka fituar popullaritet midis studiuesve të institucioneve ndërkombëtare (p.sh.: Banka Botërore, 2010; Cherif dhe Hasanov, 2019a, b; Eichengreen, 2012, 2013; Ito, 2017). Megjithatë, ekzistojnë edhe disa studiues të cilët e kanë hedhur poshtë ekzistencën e këtij kurthi me arsyetimin se nuk ka arsye të besohet se ekonomitë me

3 Eksplorimi i kurthit të të ardhurave të mesme. Banka Botërore (2010).

4 Mirupafshim, Konsensus i Uashingtonit, përhëndetje, Konfuzion i Uashingtonit? Një rishikim i rritjes ekonomike të Bankës Botërore në vitet 1990: Mësimi nga Dekada e Reformës. Dani Rodrik. Journal of Economic Literature, vëll 44, nr. 4 (2006).

5 Identifikimi dhe lehtësimi i rritjes. Roli i Shtetit në dinamikën e ndryshimit strukturor. Lin, Justin Yifu; Monga, Celestin. Dokument pune për hulumtimin e politikave; Banka Botërore (2010).

6 Një Rilindje e Azisë Lindore. Gill, Indermit; Kharas, Homi. Ide për rritjen ekonomike. Banka Botërore (2007).

të ardhura të mesme kërkojnë mekanizma të ndryshëm rritjeje (p.sh.: Aiyar, 2013; Han dhe Wei, 2017; Im dhe Rosenblatt, 2013). “Debati dhe pikëpamjet kundërthënëse gjatë dekadës së fundit në lidhje me ekzistencën e KAM-it rrjedhin si rezultat i dallimeve në përkufizimet e KAM-it dhe të metodologjive të ndryshme për të testuar ekzistencën e tij. Por pavarësisht nga ekzistenca e tij, është e qartë se shumë ekonomi me të ardhura të mesme (88 nga 101) po luftojnë për të arritur statusin e të ardhurave të larta dhe, për këtë arsye, kjo duhet të konsiderohet një çështje me rëndësi”⁷.

Për të përcaktuar variablat përgjegjës për KAM-in, studimet e Bankës Botërore, marrin në konsideratë një gamë të gjerë faktorësh të mundshëm, duke përfshirë kushtet demografike, institucionet, strukturat e industrisë dhe të tregtisë, diversifikimin e eksporteve, infrastrukturën fizike dhe zhvillimet makrofinanciare⁸.

Po ashtu, FMN-ja, nëpërmjet një analize ekonometrike të ekuacioneve të rritjes, ka testuar nëse secili prej këtyre variablave është i detyrueshëm për tranzicionin në vendet me të ardhura të mesme dhe ka identifikuar faktorë të ndryshëm për secilën fazë apo grupim vendesh sipas nivelit të të ardhurave. Gjetjet e studimit të FMN-së dhe të hulumtimeve të tjera të lidhura me faktorët e rritjes, na ndihmojnë të kuptojmë pse vetëm një numër vendesh të përzgjedhura kanë qenë në gjendje të kalojnë nga statusi me të ardhura të mesme në vende me të ardhura të larta gjatë pesë dekadave të fundit. Identifikimi i variablave kryesorë të “tranzicionit”, të cilët janë të nevojshëm për realizimin e një tranzicioni të suksesshëm, është hapi i parë drejt një politike të suksesshme industriale.

3.1.1. Institucionet

Një nga variablat e konsideruar gjerësisht për sa i përket rritjes ekonomike është ai i “institucioneve”. Një grup gjithnjë e më i madh kërkimesh i ka identifikuar ato si një faktor të rëndësishëm për rritjen ekonomike. Megjithatë, ky variabël është kritikuar për qëndrueshmërinë dhe endogjenitetin e tij, dhe, disa studime, si ai nga Glaeser⁹ (Glaeser, 2004), kanë nxjerrë në pah se forca e rëndësës qëndron në fakt të kapitali njerëzor dhe jo tek institucionet. Për më tepër, cilësia “e institucioneve” matet në aspekte të ndryshme, si sundimi i ligjit, demokracia ose stabiliteti politik (rendi). Aspektet e ndryshme të institucioneve mund të jenë të detyrueshme vetëm për një fazë të veçantë

zhvillimi. Në këtë drejtim, disa aspekte të institucioneve konsiderohen si të parëndësishme për vendet me të ardhura të mesme. Për shembull, në gjetjet e FMN-së konfirmohet se as sundimi i ligjit dhe as demokracia nuk janë veçanërisht të detyrueshme për rritjen në vendet me të ardhura të mesme, ndërkohë që stabiliteti politik është i rëndësishëm për të gjitha vendet¹⁰ (Huang dhe të tjerë, 2013; Lee dhe Kim, 2019).

3.1.2. Tregtia, struktura industriale dhe hapja

Faktorë të tjerë të rëndësishëm përfshijnë strukturën tregtare dhe industriale, si dhe liberalizimin tregtar dhe financiar. Liberalizimi financiar është problematik, pasi një nivel i lartë i hyrjeve financiare në PBB rrit probabilitetin që vendet me të ardhura të mesme të përballen me një ngadalësim të rritjes, dhe ky konstatim është në përputhje me historitë e krizave të shkaktuara nga derregullimi apo liberalizimi, të vërejtura në disa vende. Ndërkohë vende si Koreja, e arritën statusin e vendeve me të ardhura të larta nga mesi i viteve 1990, duke iu bashkuar klubit të vendeve të pasura të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), edhe pse sistemi i tyre financiar mbeti nën kontrollin e qeverisë dhe pa liberalizimin financiar të jashtëm. Papërshtatshmëria e liberalizimit financiar ose privatizimit si një parakusht për rritje përtej stadi të vendit me të ardhura të mesme është theksuar gjithashtu nga Rodrik-u¹¹, (Rodrik, 1996), i cili zbuloi se ekonomitë e Azisë Lindore, të Koresë dhe Tajvanit arritën statusin e të ardhurave të larta pa një liberalizim të tillë, ndërsa vendet e Amerikës Latine, që përqafuan një liberalizim të tillë, nuk arritën t’i mbajnë ritmet e rritjes. Kështu, hapja financiare, ose liberalizimi, nuk mund të konsiderohet si një variabël i fuqishëm për rritjen ekonomike në vendet me të ardhura të mesme, pra, nuk mund të konsiderohet një variabël kryesor i tranzicionit që do të ndihmonte për të kaluar në statusin e vendit me të ardhura të larta.

Për sa u përket përfitimeve që vijnë si rezultat i integritimit ekonomik dhe hapjes ndaj tregtisë, duhet thënë se ato janë të njohura gjerësisht në literaturë, por efektet aktuale të hapjes dhe variablat që do të përcaktonin integrimin më të mirë ndërkombëtar janë ende duke u debatuar. Ndërsa disa studime gjejnë një korrelacion pozitiv ndërmjet rritjes ekonomike dhe tregtisë së lirë, të tjera zbulojnë se hapja tregtare nuk është një faktor i fortë për rritjen ekonomike¹².

Diversifikimi i eksportit është një tjetër variabël i cili përbën objekt diskutimi. Sipas opinionit të disa studiuesve, ky variabël është i rëndësishëm për rritjen ekonomike, ndërsa

7 Lebdioi, A., Lee, K. dhe Pietrobelli, Ndërfaqja lokale e teknologjisë së huaj, zhvillimi i bazuar në burime dhe politika industriale: Si po i shpëtojnë Kili dhe Malajzia kurthit të të ardhurave të mesme. J Technol Transf 46, 660–685 (2021).

8 Identifikimi dhe lehtësimi i rritjes. Roli i Shtetit në dinamikën e ndryshimit strukturor. Lin, Justin Yifu; Monga, Celestin. Dokument pune për hulumtimin e politikave; Banka Botërore (2010).


9 A ndikojnë institucionet te rritja? Edward L. Glaeser, Rafael La Porta, Florencio Lopez-de-Silanes dhe Andrei Shleifer, Journal of Economic Growth, vëll 4 (2004).

10 Arti i arritjes ekonomike: Barrierat, devijimet dhe tejkalimet në sistemet e inovacionit.- Keun Lee Cambridge University Press (2019).

11 Kuptimi i reformës së politikës ekonomike. Dani Rodrik. Journal of Economic Literature, vëll 34, nr. 1 (1996).

12 Rodriguez dhe Rodrik (2000), Vamvakidis (2002) dhe Lee e Kim (2009).

Figura 1:

Vlera e shtuar për punëtor dhe TFP-ja

Burimi: Anketa Strukturore e Biznesit (INSTAT), të dhëna doganore.

disa të tjerë konsiderojnë specializimin e eksporteve¹³ si më të qenësishëm për rritjen. Por, pavarësisht se cilët janë përcaktuesit kryesorë të variablave të eksportit (si: avantazhet krahasuese të produkteve, konkurrueshmëria e eksporteve, diversifikimi i eksportit, procesi i të mësuarit nëpërmjet eksportimit, apo përbërja e portofolit të eksporteve), studimet kanë treguar se rritja e eksporteve është faktori më i domosdoshëm për rritjen ekonomike, për shkak se vendet në zhvillim nëpërmjet eksportit gjenerojnë valutë të huaj, e cila nevojitet për të paguar për kapitalin dhe produktet apo shërbimet e importuara. Me fjalë të tjera, rritja e eksportit nxit rritjen ekonomike duke gjeneruar valutë të huaj, e cila mundëson importimin e makinerive dhe të mallrave të ndërmjetme, që janë të nevojshme për investime¹⁴.

Një faktor i dytë, i cili mbështet rëndësinë e eksportit për rritjen ekonomike, lidhet me faktin se firmat që prodhojnë produkte që eksportohen janë më produktive. Në një përfundim të tillë ka arritur edhe Studimi i Bankës

Botërore mbi produktivitetin në nivel firme në Shqipëri, i cili tregon se orientimi drejt eksportit ndikon në rritjen e produktivitetit të firmës. Në Shqipëri, firmat që eksportojnë janë dy herë më produktive sesa ato që nuk eksportojnë¹⁵.

Polemika të shumta ekzistojnë edhe mbi variablin e IHD-ve, ku studiuesit janë ndarë në dy grupe pro dhe skeptikë karshi IHD-ve¹⁶. Në literaturë, por edhe në mendimin e përgjithshëm ekonomik, IHD-të konsiderohen kritike për krijimin e vendeve të punës. Por, me sa duket, kjo mbështetje, qoftë edhe pasive, është e rëndësishme deri në momentin që vendi arrin stadin e vendit me të ardhura të mesme. E njëjta gjë vërehet edhe në Shqipëri. "Krijimi i vendeve të punës nga firmat në pronësi të huaj ka rënë në periudhën 2012–2016. Ne besojmë se numri në rënie i vendeve të punës të krijuara nga IHD-të lidhet me strukturën e IHD-ve. Megjithëse hyrjet e IHD-ve mbeten të qëndrueshme, në 8,1% të PBB-së mesatarisht, ato


13 Pikëpamjet pro diversifikimit përfshijnë Hessen-in (2009), Amurgo-Pacheco-n dhe Pierola-n (2008) dhe Dennis-in dhe Shepherd-in (2007), ndërsa këndvështrimi pro specializimit përfshin Plümper-in dhe Graff-in (2001), Dalum et al. (1999), Greenaway et al. (1999) dhe Fosu-n (1990).

14 (Brenton et al., 2010; Besedes dhe Prusa, 2006; Nitsch, 2009; Fugazza dhe Molina, 2009; Hausman et al., 2007).

15 Mbështetje për zbatimin e politikave të rritjes dhe punësimit në Shqipëri. Zhblokimi i rritjes dhe punësimit nëpërmjet produktivitetit: Një diagnostikim në nivel firme, Banka Botërore, qershor 2019.

16 Grupi pro IHD-ve përfshin Hermes-in dhe Lensink-in (2003), Alfaro-n et al. (2004), Balasubramanyam-in et al. (1996), Durham-in (2004), Doytch-i dhe Uctum-in (2011), Borensztein-in et al. (1998), Hsiao-n dhe Shen-in (2003), dhe Makki-n dhe Somwaru-n (2004), ndërsa grupi skeptik përfshin Carkovic-in dhe Levine-n (2002) dhe Adams-in (2009).

Figura 2:

Krijimi i vendeve të punës neto nga statusi eksportues i firmave prodhuese

Burimi: Anкета Strukturore e Biznesit (INSTAT), të dhëna doganore.

kanë një ndikim të vogël në krijimin e vendeve të punës afatmesme”¹⁷ (Banka Botërore).

Pavarësisht se niveli i investimeve të huaja mbetet i qëndrueshëm, ngadalësimi në procesin e diversifikimit të tyre reflektohet në rënien e numrit të vendeve të punës që krijohen nga ndërmarrjet në pronësi të huaj. Ndërsa në vitin 2012 firmat në pronësi të huaj kontribuan në rreth 13 000 vende të reja pune, në vitin 2016 kjo shifër nuk arriti as në 500 [vende pune]. Ndërsa dy projektet e mëdha të drejtuara nga IHD-të, Gazsjellësi TransAdriatik (TAP) dhe Hidrocentrali i Devollit, kanë përfunduar, pritjet e Bankës Botërore janë që trendi i uljes të vazhdojë¹⁸.

Këto gjetje i përshtaten pikërisht dyshimit se politikat tradicionale që tentojnë thjesht lehtësimin tregtar apo një nivel të lartë IHD-sh nuk janë të mjaftueshme për vendet në zhvillim. Me fjalë të tjera, niveli i IHD-ve dhe hapja e ekonomisë janë parakushte për integrimin e një ekonomie në kanalet ndërkombëtare të vlerës dhe shpërndarjes, por nuk garantojnë domosdoshmërisht rritje të qëndrueshme ekonomike. Është fakt që këto politika nuk çojnë domosdoshmërisht në rritjen e eksportit dhe krijimin e vendeve të punës në afat të gjatë, pasi jo domosdoshmërisht rritin aftësinë e firmave vendase dhe investimet në inovacion. Ky vëzhgim është në përputhje

me përvojat e suksesit të arritur nga ekonomitë aziatike, si Koreja, Tajvani dhe Kina. E ndërsa hapja duket se është një tipar i rëndësishëm i shumë vendeve me të ardhura të larta dhe një kusht i domosdoshëm për të kaluar në statusin e vendit me të ardhura të larta, pamjaftueshmëria e saj për kalimin nga vend me të ardhura të mesme në vend me të ardhura të larta është e evidente.

Një argument tjetër, i mbështetur fort nga studimi i Eichengreen-it¹⁹ (2012, 2013) dhe i sponsorizuar nga ADB-ja (Banka Aziatike e Zhvillimit), është se aftësitë për inovacion janë kushti kryesor i detyrueshëm për të tejkaluar kurthin e të ardhurave të mesme (KAM). Kjo pikëpamje është gjithashtu në përputhje me deklaratën e hershme të Bankës Botërore se “ekonomitë me të ardhura të mesme priren të bien në një kurth stanjacioni, sepse ato detyrohen të operojnë midis prodhuesve me paga të ulëta dhe prodhuesve novatorë me paga të larta; niveli i tyre i pagave është i lartë për të konkurruar me eksportuesit me paga të ulëta, ndërkohë që niveli i aftësive të tyre teknologjike është shumë i ulët për t’iu mundësuar konkurrimin me vendet e përparuara”²⁰. Kështu, kurthi i të ardhurave të mesme është pamundësia për të kaluar nga ekonomi me të ardhura të mesme në ekonomi me të ardhura të larta, si pasojë e mungesës

17 Mbështetje për zbatimin e politikave të rritjes dhe punësimit në Shqipëri. Zhbllokimi i rritjes dhe punësimit nëpërmjet produktivitetit: Një diagnostikim në nivel firme, Banka Botërore, qershor 2019.

18 Mbështetje për zbatimin e politikave të rritjes dhe punësimit në Shqipëri. Zhbllokimi i rritjes dhe punësimit nëpërmjet produktivitetit: Një diagnostikim në nivel firme, Banka Botërore, qershor 2019.

19 Ngadalësimi i rritjes: Evidenca të reja të kurthit të të ardhurave të mesme, Barry Eichengreen, Parku Donghyun, Kwanho Shin. janar (2013)

20 Lebdioui, A., Lee, K. dhe Pietrobelli, C. Ndërfaqja lokale e teknologjisë së huaj, zhvillimi i bazuar në burime dhe politika industriale: Si po i shpëtojnë Kili dhe Malajzia kurthit të të ardhurave të mesme. J Technol Transf 46, 660–685 (2021).

së aftësisë për të mbështetur rritjen e vazhdueshme të eksporteve. Siç u diskutua më lart, ritmi i rritjes së eksportit është i rëndësishëm në të gjitha fazat e zhvillimit. Por faktorët që mbështetin rritjen e eksportit kanë tendencë të jenë të ndryshëm në secilën fazë të zhvillimit. Në një vend me të ardhura të larta, inovacioni është faktor bazë për mbështetjen e eksporteve. Ndërkohë, vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme priren të konkurrojnë me njëri-tjetrin bazuar në çmime dhe jo në inovacion, duke shkaktuar kështu problemin e “mbingopjes” së tregut me produkte të njëjta ose të

ngjashme dhe, si pasojë, rënien e çmimit të mallrave. Paaftësia për inovacion i shtyn vendet e rëna në kurthin e të ardhurave të mesme ta bazojnë rritjen e eksporteve në çmimet e ulëta, të cilat janë rrjedhojë e një monedhe të nënvlerësuar apo e krahut të lirë të punës, në pamundësi për të ofruar një produkt të diferencuar. Si përfundim, KAM-i është situata e ngadalësimit të rritjes ekonomike që rezulton nga inovacioni i dobët. Është pikërisht aftësia për inovacion variabli kryesor apo virtyti ekonomik i cili mundëson kalimin e një vendi me të ardhura të mesme si Shqipëria, në një vend me të ardhura të larta.

4

SHTEGU I NGUSHTË I ZHVILLIMIT TË SHQIPËRISË

4.1. STATUSI AKTUAL I ZHVILLIMIT

Pas daljes nga 50 vitet e sundimit komunist, kalimi nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të orientuar drejt tregut, i shoqëruar dhe me ndihmat e bollshme ndërkombëtare si në aspektin e hartimit të strategjive, ashtu edhe në atë të mbështetjes financiare, e ndihmuan vendin të bënte përparim. Falë performancës së fortë të rritjes, Shqipëria u rrit nga vendi më i varfër në Europë në fillim të viteve 1990, në një vend me të ardhura të mesme në vitin 2008. Siç tregohet nga indikatorët bazë ekonomikë, shërbimet kontribuojnë me 47,9% të PBB-së (2018) dhe sektori tjetër i rëndësishëm është sektori bujqësor, i cili zë 18,4% të PBB-së. Kontribuesit e tjerë në PBB janë industria dhe ndërtimi (me 21,3%)²¹. Pas viteve 2000, emigrimi dhe urbanizimi sollën një zhvendosje strukturore nga bujqësia drejt industrisë dhe shërbimeve, duke ndikuar edhe në një diversifikim të shërbimeve brenda ekonomisë shqiptare, me përfshirjen e bankave, të telekomunikacionit dhe turizmit. Sektori i prodhimit kontribuoi vetëm me 5,9% në PBB, në 2018-n. Sipas Indeksit të Performancës Industriale Konkurruese në 2019, Shqipëria renditet e 105-ta nga 150 vende, duke rënë pesë vende në krahasim me vitin 2018.

4.1.1. Një përmbledhje e shkurtër

Para vitit 1990, Shqipëria ishte një vend jashtëzakonisht i izoluar me një ekonomi komuniste të centralizuar për më shumë se katër dekada. Pas rënies së komunizmit, vendi hyri në një periudhë të paqëndrueshme tranzicioni ekonomik, i cili kulmoi me ngritjen dhe kolapsin e disa skemave piramidale masive në vitet 1996–1997, çka u shoqëruara nga një periudhë gjashtëmujore konflikti dhe përçarjeje shoqërore, duke çuar në përmbysjen e qeverisë. Pas rënies drastike të 1997-s, Shqipëria e arriti nivelin e të ardhurave për frymë të paratranzicionit rreth viteve 2000. Konvergjenca me vendet e zhvilluara filloi vetëm pas vitit 2000. Dinamika e rritjes ndryshoi shumë në periudhën


2000–2008 para krizës financiare globale, kur rritja ishte e shpejtë dhe konvergjenca e qëndrueshme. Pas asaj periudhe, rritja është ngadalësuar dhe konvergjenca ka ngecur. Shqipëria përjetoi rritjen më të shpejtë ekonomike në Europë në dekadën para vitit 2008, ku rritja reale e PBB-së për frymë ishte mesatarisht mbi 6% në vit. Për më tepër, kjo rritje ishte kryesisht pro varfërisë, pasi konsumi tentonte të rritej më shpejt për 40% të familjeve me të ardhura më të ulëta, sesa për 60% me të ardhura më të larta, dhe shkalla e varfërisë kombëtare ra nga 25,4% në 2002 në 12,5% në 2008. Remitancat luajtën një rol të madh në procesin e rritjes, ku hyrjet nga dërgesat personale arritën mesatarisht 15,2% të PBB-së midis viteve 2000 dhe 2008.

Edhe pse nuk ishin faktori i vetëm në lojë, flukset e dërgesave të emigrantëve ndihmuan në rritjen e fortë të kërkesës së brendshme për ndërtim dhe shërbime. Rritja e kërkesës së brendshme, së bashku me emigrimin e shumë shqiptarëve në moshë pune, çuan në rritjen e pagave dhe të investimeve. Disa aktivitete të reja ekonomike u shfaqën gjatë kësaj periudhe. Shqipëria u diversifikua shumë në shërbime financiare, sigurime dhe shërbime profesionale gjatë viteve 2000. Investimet e huaja direkte italiane ndihmuan në krijimin e sektorit të fasonit (tekstile dhe këpucë) në Shqipëri. Ngadalësimi i rritjes ishte i vështirë për t'u shmangur pas vitit 2008, duke pasur parasysh lidhjet e ngushta tregtare dhe investuese të Shqipërisë me Italinë dhe Greqinë, dy vende që hynë në recesion të thellë pas 2008-s. Modelet e emigrimit shqiptar përcaktuan se burimi i dërgesave të emigrantëve varej fort nga shëndeti ekonomik i këtyre dy vendeve. Për më tepër, nuk duhet harruar ndikimi i faktorëve strukturorë. Në vitin 2008, Shqipëria arriti statusin e vendit me të ardhura të nivelit të mesëm.

Pas këtij viti, sektori prodhues i Shqipërisë u përball me konkurrencën në rritje të çmimeve dhe rrezikun e zhvendosjes së fabrikave dhe investimeve në vende me kosto më të lira pune. Rënia në kurthin e të ardhurave të mesme do të ishte një shpjegim për mungesën e rritjes së qëndrueshme në Shqipëri. Kjo shpjegon edhe

21 <https://data.worldbank.org/indicator/BX.TRF.PWKR.DT.GD.ZS?locations=AL>

Figura 3:

Vlera e shtuar për punëtor (krahasuar me BE 28-n)

ngadalësimet në normat e rritjes së produktivitetit, pasi përfitimet nga puna me kosto të ulët dhe imitimi i teknologjisë së huaj u zvogëluan, duke e bërë të vështirë apo gati të pamundur kalimin në faza të tjera zhvillimi. Pagat u rritën, po kështu edhe konkurrenca, veçanërisht për sektorin e prodhimit. Ky sektor karakterizohet nga produktiviteti i ulët, diversifikimi dhe sofistikimi i kufizuar i produkteve dhe, si rrjedhim, ka një konkurrueshmëri të dobët. Shqipëria ka një deficit të konsiderueshëm tregtar dhe një bilanc negativ për produktet e prodhuara, veçanërisht në sektorët e industrisë kimike, të industrisë mekanike, të produkteve të lëkurës, të përpunimit të metaleve dhe në sektorët e materialeve të ndërtimit.


Oferta e eksportit është e kufizuar dhe dominohet më së shumti nga tekstilet dhe veshjet, si dhe këpucët. Vendi vuan nga përdorimi i energjisë me intensitete të larta, vlera e shtuar e ulët, prodhimi bazohet në krahun e punës, si dhe ka mospërputhje aftësish dhe praktika të dobëta mjedisore. Diversifikimi ekonomik është i ulët edhe për shkak të aksesit të kufizuar në financa dhe boshllëqeve të mëdha të njohurive. Lidhjet ndërmjet kompanive janë të papërshtatshme si pasojë e zhvillimit të dobët të teknologjisë dhe mungesës së sofistikimit dhe inovacionit të ulët në sektorin privat. 60% e mallrave të eksportuara shqiptare janë produkte me vlerë të ulët. Në mënyrë të ngjashme, shërbimet tradicionale përfaqësojnë pothuajse 80% të eksporteve të përgjithshme të shërbimeve. Cilësia e matur në aspektin e klasifikimit teknologjik të eksporteve apo e përfaqësuar nga indeksi i sofistikimit të eksportit është modeste. Shkalla e mbijetesës e eksporteve shqiptare është shumë më e ulët se niveli i mbijetesës i eksporteve të fqinjëve tanë.

4.2. MODELI EKONOMIK NUK E MBËSHTET RITJEN E PRODUKTIVITETIT

Pas vitit 1990, Shqipëria zbatoi rekomandimet standarde të politikave të rritjes, përmirësimin e institucioneve dhe të mjedisit të biznesit, ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, investimin në infrastrukturë dhe kapitalin njerëzor, privatizimin e aseteve shtetërore dhe derregullimin e aktivitetit privat. Këto receta trajtojnë ato që në literaturë përshkruhen si “dështime të qeverisë” (Rodrik, 2005). Dështime të tilla lidhen me inflacionin e lartë, shpenzimet e tepërta të qeverisë, ndërmarrjet shtetërore jofitimprurëse, monopolet, pengesat në investime, si burokracia dhe korrupsioni, pasiguria në lidhje me të drejtat e pronësisë, rregullat e pajustificuara mbi punën, si dhe llojet e tjera të shtrembërimeve që rrjedhin kryesisht nga vendimmarrjet e qeverisë. Shteti në këtë model nuk ndërhyr në dinamikën e tregut, duke e lënë ekonominë në një gjendje *laissez faire*. Nëse do t’u referoheshim marsheve të politikës industriale, Shqipëria ka ecur me më të ulët, atë të “zvarritjes së kërmillit”. Përveçse vuan nga produktiviteti i ulët, që prej vitit 2014, vendi po përjeton një rënie të tij (Banka Botërore, 2019). “Sipas vlerësimeve të produktivitetit, midis viteve 2014 dhe 2016, rritja e produktivitetit ishte e ulët ose negative. Të dy matësit, si vlera e shtuar për punëtor, dhe Faktori Total i Produktivitetit (TFP), kanë përjetuar një rënie në periudhën 2014–2016. Vlera e shtuar për punëtor ra me 6% në prodhim dhe me 2% në shërbime, e po kështu edhe TFP-ja, duke shënuar një rënie prej 1% në prodhim dhe 6% në shërbime. Të dhënat në nivel firme konfirmojnë se produktiviteti në Shqipëri është i ulët krahasuar me BE-në dhe vendet

Figura 4:

Faktori total i produktivitetit kundrejt vlerës së shtuar për punonjës në shërbimet e prodhimit




fqinje. Vlera e shtuar për një punëtor, si një nga matësit e produktivitetit, konfirmon se kompanitë shqiptare janë rreth 3 herë më pak produktive sesa kompanitë e Maqedonisë së Veriut dhe 7-10 herë më pak produktive se një kompani mesatare e BE-së. Produktiviteti relativ është veçanërisht i ulët në sektorët e prodhimit (vlera e

shtuar për punëtor është sa 8% e firmës mesatare në BE) dhe, në sektorët hotelieri dhe restorante, vlera mesatare e shtuar për punëtor është sa 9% e firmës mesatare në BE. Tregtia, transporti dhe TIK-u kanë nivele më të larta të produktivitetit relativ, por megjithatë mbeten të ulëta në krahasim me rajonin dhe BE-në. Kur rezultatet

Figura 5:

Pjesa e punësimit sipas intensitetit të përdorimit të teknologjisë, 2016



korrigjojnë me fuqinë blerëse, firmat shqiptare rezultojnë rreth 2,4–4,9 herë më pak produktive se mesatarja e BE-së²².

Krahasuar me vendet e rajonit, Shqipërisë i mungon punësimi në industri me intensitet të lartë dhe sofistikim teknologjik. 80% e fuqisë punëtore në sektorin formal të prodhimit punon në sektorë me intensitet të ulët teknologjik (p.sh., në prodhimin e ushqimeve dhe pijeve, tekstileve dhe veshjeve, prodhimet e drurit dhe të mobiljeve) dhe 17% në industrinë me intensitet teknologjik të mesëm dhe të ulët (p.sh.: metale, materiale, minerale, instalim pajisjesh). Punësimi në industrinë me intensitet teknologjik të mesëm (p.sh.: automjete, kimikate, makineri dhe pajisje) dhe në industrinë e teknologjisë së lartë (p.sh.: kompjutera dhe elektronikë, farmaceutikë) është i papërfillshëm. Pjesa e punësimit në industrinë e teknologjisë së mesme të lartë është dukshëm më e lartë në Kroaci, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi (Banka Botërore, 2019)²³.

Rritja e punësimit, e kombinuar me rritjen produktive negative, sugjeron që vendet e punës janë krijuar nga firma më pak produktive. Kjo do të thotë që kapitali dhe puna nuk po drejtohen nga aktivitetet produktive. Së dyti, punësimi nuk lidhet me firmat që kanë adoptuar praktikat më të mira menaxheriale, që tentojnë të rritin aftësitë e punëtorëve dhe të drejtimit. Punësimi ka karakteristikat e një “force punëtore të fshehur”, e cila nuk ndihmon rritjen. Ekonomia shqiptare është e bllokuar në statusin e ekonomisë me produktivitet të ulët jo vetëm si rezultat i shtrembërimeve që rrjedhin nga dështimet e qeverisë, por edhe si rezultat i dështimeve të tregut dhe dështimeve të tjera më komplekse, si dështimet e koordinimit të eksternaliteteve të lidhura me procesin e të mësuarit dhe të shpërndarjes së njohurive, si dhe nga fragmentarizimi i tejskajshëm, i cili quhet dështim i madhësisë së biznesit.

4.2.1. Njohuritë produktive. Dështimi i aftësisë

Stiglitz-i dhe Greenwald-i (2014) argumentojnë se “ajo që ndan vendet e përparuara nga vendet në zhvillim është hendeku në njohuri”. Në këtë kontekst, Shqipëria përballlet me një kufizim unik të njohurive, i cili është i rrënjësor thellë në të kaluarën e saj të mbyllur. Pas rënies së komunizmit, sektori privat u rrit nga ajo që njerëzit dinin të bënin. Megjithatë rëndësia e inovacionit është e njohur gjerësisht, tejkalimi i kufizimit të njohurive produktive nuk ka qenë i lehtë në Shqipëri.

Kufizimi i njohurive mund të gjendet te matja direkte e sofistikimit të biznesit, apo edhe te vlerësimet indirekte bazuar në të dhënat e tregtisë ndërkombëtare. Janë

po ashtu të vlefshme vëzhgimet cilësore të boshllëqeve në zinxhirin e vlerës apo të shpërndarjes së njohurive. Krahasimet me referencat ndërkombëtare tregojnë se kompania tipike shqiptare është e thjeshtë, ka relativisht pak eksperiencë specifike për sektorin ku operon, i mungojnë shumë mjete moderne që përdoren sot gjerësisht nga sektori privat dhe ndërvepron pak me sektorin financiar. Përgjigjet e Anketës Botërore të Ndërmarrjeve tregojnë se firmat shqiptare kanë mbetur shumë më mbrapa sesa firmat që operojnë në vende të tjera të ngjashme apo me të njëjtin nivel të ardhurash për frymë, kryesisht në indikatorët që lidhen me inovacionin. Në krahasim me vendet e tjera të rajonit, Shqipëria tenton të ketë firmat më të reja në moshë, menaxherë me më pak përvojë dhe një sofistikim shumë të ulët financiar²⁴. Këto karakteristika të firmave shqiptare, kanë çuar në dështimin e ngritjes së aftësisë, e cila është një simptomë që i referohet vështirësisë së brendshme të një ekonomie për të krijuar dhe rritur aftësi inovative.

Dështimi i aftësisë, në fakt, është një dështim kompleks, i cili përfshin dështimin e tregut, dështimin e sistemit dhe dështimin e të mësuarit. Dështimi i tregut në inovacione ka bazën tek eksternalitetet e dijes si e mirë publike. Në rastin e dështimit të tregut, subvencionet në sasi optimale për të mbështetur kërkim-zhvillimin do të ishin receta kuruese e problemit. Por në kushtet kur dështimi është më kompleks se kaq, duke tejkalluar dështimin e tregut, subvencionet nuk përbëjnë më zgjedhje. Në fakt, dështimi i tregut bazohet në supozimin e zakonshëm, megjithatë të fshehur, se firmat dhe aktorët e tjerë ekonomikë janë tashmë të aftë për inovacione dhe, në këtë rast, stimujt monetarë do të vepronin si një zgjidhje e problemit. Por realiteti është krejt tjetër në Shqipëri. Problemi e ka filluesin te fakti që aktorët ekonomikë, veçanërisht firmat, kanë nivele jashtëzakonisht të dobëta të aftësisë zhvilluese dhe kërkuese dhe nuk janë në gjendje të ndjekin apo të kryejnë kërkim dhe zhvillim të brendshëm. Ato me të drejtë e konsiderojnë punën kërkimore-zhvillimore si një përpjekje të pasigurt me kthime të pasigurta. Në këto kushte, problemi që shtrohet nuk është “më shumë apo më pak shpenzime për kërkim-zhvillim”, por se kërkim-zhvillimi është një aktivitet që nuk kryhet. Kjo formëzon mungesën e aftësisë për t’u zhvilluar së brendshmi dhe është shkaku kryesor për diversifikimin dhe sofistikimin e dobët të eksporteve shqiptare. Eksportet e vendit nuk janë gjë tjetër veçse produktet me të cilat firmat e vendit konkurrojnë ndërkombëtarisht. Niveli i ulët i eksporteve reflekton po ashtu një nivel të ulët të njohurive produktive të firmave. Eksportet e Shqipërisë si përqindje e PBB-së janë të ulëta, dhe vetëm një përqindje e vogël e firmave shqiptare janë eksportuese. Në të dyja këto matje, të dhënat e fundit tregojnë se Shqipëria performon me keq se rajoni.

22 Mbështetje për zbatimin e politikave të rritjes dhe punësimit në Shqipëri. Zhbllokimi i rritjes dhe punësimit nëpërmjet produktivitetit: Një diagnostikim në nivel firme, Banka Botërore, qershor 2019.

23 Po aty.

24 Çfarë e kufizon rritjen në Shqipëri, T.O’Brien L.Nedelkoska, E. Frasheri - CID Harvard 2017

Figura 6:

Rritja e PBB-së së Shqipërisë krahasuar me Greqinë, Italinë dhe Ballkanin Perëndimor


Burimi: Treguesit e zhvillimit botëror

Një matës tjetër është Indeksi i Kompleksitetit Ekonomik (IKE), i cili siguron një matje sasiore të njohurive produktive të një vendi. IKE-ja për Shqipërinë është më e ulët nga sa pritej, bazuar në nivelin e të ardhurave të vendit, gjë që tregon se struktura e prodhimit nuk mund ta mbështetë rritjen e qëndrueshme. Kjo duhet thënë që është karakteristikë e vendeve të pasura me burime natyrore, siç është rasti i Shqipërisë. Shfrytëzimi i këtyre burimeve e ka ndihmuar Shqipërinë për kalimin nga statusi i vendit me të ardhura të ulëta në vend me të ardhura të mesme, duke rritur të ardhurat për frymë, por padyshim në stadin ku ndodhemi mbështetja vetëm te burimet natyrore nuk mund të sigurojë rritje afatgjatë. Ndërkohë ato e kanë ekspozuar ekonominë ndaj goditjeve të ndryshimit të çmimeve dhe ndaj ndryshimeve afatgjata të ofertës dhe kërkesës për to. Bazuar në kompleksitetin ekonomik, Shqipëria renditet kështu e 108-ta nga 121 vende, rritja

vjetore e parashikuar për vendin tonë gjatë dekadës së ardhshme është vetëm 1,83%. Këto fakte sugjerojnë se Shqipëria e ka të domosdoshëm shtimin e njohurive produktive, në mënyrë që të ushqejë rritjen afatgjatë²⁵.


Duke pasur aftësi kërkimore dhe zhvilluese jashtëzakonisht të ulëta, mënyra më e sigurt për të bërë biznes për firmat shqiptare, ka qenë blerja ose huazimi i teknologjive të huaja, i pajisjeve të prodhimit, si dhe specializimi në procese më pak teknike, siç është montimi.

Një fakt tjetër shumë i rëndësishëm, që nënvizon mbështetjen pasive dhe jo afatgjatë që mund të japin investimet e huaja të deritanishme, është transferimi i

25 Shiko projektimin e rritjes nga CID-i, bazuar në të dhënat e tregtisë: <http://atlas.cid.harvard.edu/rankings/growth-predictions-list/>

Figura 7:


Reflektime të aftësisë së ulët të firmave shqiptare: mosha e firmës; përvoja e menaxherit; përdorimi i postës elektronike dhe pasqyrat financiare të rishikuara nga auditorët e jashtëm



Burimi i të dhënave: Anketat e Ndërmarrjeve të Bankës Botërore, Treguesit e Zhvillimit Botëror

Figura 8:


Eksportet si përqindje e PBB-së dhe përqindja e firmave shqiptare që eksportojnë



Burimi i të dhënave: Treguesit e Zhvillimit Botëror, duke përfshirë Hong Kongun, Singaporin dhe Luksemburgun

Burimi i të dhënave: Anketat e Ndërmarrjeve të Bankës Botërore, Treguesit e Zhvillimit Botëror

Figura 9:
Kompleksiteti Ekonomik kundrejt PBB-së për frymë, 2014



Burimi: Atlasi i Kompleksitetit Ekonomik, Treguesit e Zhvillimit Botëror – parashikimet e rritjes të CID-it bazuar në të dhënat e tregtisë:
<http://atlas.cid.harvard.edu/rankings/growthpredictions-list>

njohurive. Edhe pse jemi vendi i dytë në rajon për nga niveli i investimeve të huaja, duket se ato kanë ndikuar pak në rritjen e njohurive në vend. Pra, transmetimi i njohurive nuk ka qenë i mjaftueshëm. Kjo pamjaftueshmëri e ka bazën te mungesa e diversifikimit sektorial të IHD-ve. Kompanitë e huaja në Shqipëri kanë investuar më së shumti në shfrytëzimin e burimeve natyrore (naftë, metale dhe ujë), në sektorin e shërbimeve financiare, si dhe në aktivitetet fundore të cikleve të prodhimit (siç është montimi), duke shfrytëzuar krahun e lirë të punës. Vlera e shtuar e aktivitetit të tyre në Shqipëri ka qenë përgjithësisht e ulët. Kjo shpërndarje sektoriale nuk ofron qëndrueshmëri në planin afatgjatë, pasi jo vetëm burimet natyrore janë të kufizuara, por çdo ditë e më shumë rritet presioni i nivelit të pagave, duke detyruar një pjesë të investitorëve, që kanë ardhur kryesisht për shfrytëzimin e krahut të lirë të punës, të lëvizin drejt vendeve me paga më të ulëta. Edhe pse qeveritë shqiptare të të gjitha kohërave kanë hartuar strategji për thithjen e investimeve të huaja direkte, kanë ngritur infrastrukturë administrative dhe ligjore për tërheqjen e tyre (agjenci, ligje të posaçme), aftësia e tërheqjes së investimeve të reja duket se po kufizohet. P.sh., në vitin 2013, fluksi i investimeve të huaja ishte 9,8% e PBB-së dhe në 2018-n, flukset e investimeve të huaja ranë në 8% të PBB-së.

Elementi i dytë është mungesa e diversifikimit burimor të IHD-ve. Shqipëria ka arritur të tërheqë investime nga vende që, po ashtu si ne, kanë njohuri të ulëta produktive, siç është rasti i Greqisë, i cili është vendi tjetër në rajon ku IKE-ja është më e ulët se ç’parashikohej. Fatkeqësisht, IHD-të greke kanë kapur rreth një të katërtën e totalit të investimeve të huaja dhe Greqia është ndër pesë vendet e para burimore të IHD-ve në Shqipëri.

Përveç pamundësisë për të kryer kërkim-zhvillim në nivel firme, Shqipërisë i mungojnë Sistemet Kombëtare të Inovacionit (që mund të quhen dështim sistemi). Një Sistem Kombëtar Inovacioni në një sektor të caktuar përbëhet nga firma, universitete, laboratorë kërkimi publikë, agjenci qeveritare dhe institucione financiare. Mungesa e këtij sistemi largon ose rrit distancën e bashkëpunimit midis këtyre aktorëve, duke i lënë ata të izoluar dhe jo interaktivë. Një situatë dështimi në krijimin e sistemeve i lë aktorët të mbyllur në rrethin vicioz të njohurive që zotërojnë, duke mos pasur kështu asnjë mundësi t’i zgjerojnë apo t’i korrigjojnë ato, situatë që çon në aftësi të ulëta të të nxënit.

Kjo mangësi në krijimin dhe shpërndarjen e njohurive ka si rezultat alokimin aktual të kapitaleve, investimeve dhe

punës, i cili përqendrohet në aktivitete që kanë pak ose aspak nevojë për njohuri, duke ndikuar edhe te shterpësia e krijimit të njohurive shtesë. Sipas vrojtit strukturor të ndërmarrjeve ekonomike, shumica e ndërmarrjeve, 87,3%, operojnë në aktivitetet e shërbimit dhe realizojnë 67,3% të qarkullimit të përgjithshëm vjetor. Në këtë grup ndërmarrjesh, tregtia e automjeteve, tregtia me shumicë dhe pakicë ka pjesën më të madhe të ofruesve të shërbimeve. Në sektorin e tregtisë operojnë 40,0% e ndërmarrjeve, të cilat realizojnë 46,2% të xhiros totale vjetore. Me gjithë qarkullimet dhe burimet e mëdha, shumë nga lojtarët e mëdhenj nuk shpenzojnë asnjë burim financiar për kërkim-zhvillim. Ata janë kryesisht “kërkues të qirasë” dhe nuk kanë asnjë ndikim apo investime afatgjata në kërkim-zhvillim.

Kjo situatë krijon një implikim të tretë, dështimin për të shpërndarë njohuri. Mësimi duke punuar, ose ndryshe procesi i të mësuarit nëpërmjet punës, është një nga kanalet më të rëndësishme të grumbullimit të njohurive dhe aftësisë të kapitalit njerëzor. Struktura e mësipërme ekonomike, si dhe kryerja e të njëjtit grup aktivitetesh që kërkonin pak ose aspak njohuri rezultoi në stanjacionin e produktivitetit në Shqipëri. “Në të kundërt, nëse do të ushqeheshin apo drejtoheshin tendencat për të provuar aktivitete të reja dhe më komplekse, menaxherëve dhe punëtorëve do t’u jepej mundësia të mësonin vazhdimisht dhe të ngjithnin ‘shkallët e cilësisë’” (Aghion dhe Howitt, 1992). Ky dështim ndodh jo vetëm prej faktit se njohuria nuk është një e mirë publike, por edhe për shkak të mungesës së çdo kapaciteti apo mundësie për ta krijuar dhe shpërndarë atë, elemente këto që rezultojnë nga kushtet e trashëguara historikisht, por edhe nga dështimi i politikave.

Për të tejkaluar një gjendje të tillë, për të ridrejtuar alokimin e kapitalit, format efektive të ndërhyrjes së qeverisë nuk mund dhe nuk duhet kurrsesi të kufizohen vetëm te sigurimi i fondeve për kërkim-zhvillim. Detyra është

shumë më komplekse. Duhet synuar ngritja e kapaciteve dhe aftësive për të kryer kërkim-zhvillim brenda firmave vendase. Një problem i zakonshëm për Shqipërinë është tendenca për t’u kufizuar vetëm në stimulimin tatimor, pa krijuar sistemet e nevojshme apo infrastrukturën bazë që do t’i shtynte firmat të ndërmerrnin aktivitete me rreziqe më të mëdha, si kërkim-zhvillimi dhe inovacioni. Format më efektive dhe alternative të ndërhyrjes mund të përfshijnë transferimin e njohurive të kërkim-zhvillimit të krijuara në institutet kërkimore publike (të cilat, si fillim, duhet të krijohen) dhe krijimin e konsorciumeve publike-private rreth një sektori për kërkimin dhe zhvillimin, të cilat kanë rezultuar të suksesshme në vende të tjera në zhvillim, si Koreja, Tajvani, Kili, Malajzia etj.

4.2.2. Struktura e ndërmarrjes. Dështimi i madhësisë së biznesit

Gjatë vitit 2018, analiza e treguesve sipas klasës së madhësisë së ndërmarrjeve në Shqipëri tregoi se ndërmarrjet me 250 ose më shumë të punësuar përbënin 0,2% të ndërmarrjeve aktive, ato realizonin 22,6% të qarkullimit, angazhonin 20,2% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve dhe kishin kryer 29,4% të totalit të investimeve. Ndërmarrjet me 1–9 të punësuar janë ato që mbizotërojnë me 93,9% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive. Këto ndërmarrje angazhuan 37,8% të totalit të punësuar dhe realizuan 18,8% të qarkullimit të përgjithshëm.

Ndërmarrjet shqiptare janë më të vogla se firmat e ngjashme në rajon dhe në Bashkimin Europian. Firma mesatare prodhuese në Shqipëri është pothuajse sa një e treta e firmës mesatare prodhuese në BE, dhe ky raport është edhe më i keq për sektorët e tregtisë, të transportit dhe hotelerisë (Banka Botërore, 2019). Kjo sugjeron se në krahasim me firmat në rajon, kompanitë shqiptare priren të operojnë në ekonomi shkalle më të vogël, duke krijuar një ekonomi tejet të fragmentarizuar.

Tabela 1:

Struktura e ndërmarrjeve nga punësimi

		Mikro (1–9 të punësuar)	Të vogla (10–49 të punësuar)	Të mesme (50–249 të punësuar)	NVM (1–249 të punësuar)	Të mëdha (250+ të punësuar)	Totali
Ndërmarrjet	Nr.	100 876	5 246	1 147	107 269	181	107 450
	%	93,90%	4,90%	1,10%	99,80%	0,20%	100,00%
Të punësuar	Nr.	194 867	102 950	113 911	411 727	103 979	515 706
	%	37,80%	20,00%	22,10%	79,80%	20,20%	100,00%

Burimi: INSTAT

Tabela 2:

Struktura e ndërmarrjeve sipas qarkullimit, investimeve dhe vlerës së shtuar


		Mikro (1–9 të punësuar)	Të vogla (10–49 të punësuar)	Të mesme (50–249 të punësuar)	NVM (1–249 të punësuar)	Të mëdha (250+ të punësuar)	Totali
Shitje neto	Milionë lekë	409 991	713 963	564 666	1 688 620	491 685	2 180 350
	%	18,80%	32,70%	25,90%	77,40%	22,60%	100,00%
Investime	Milionë lekë	32 469	65 700	69 935	168 104	70 041	238 145
	%	13,60%	27,60%	29,40%	70,60%	29,40%	100,00%
Vlera eshtuar	Milionë lekë	116 099	130 690	143 799	390 588	174 890	565 478
	%	20,50%	23,10%	25,40%	69,10%	30,90%	100,00%

Burimi: INSTAT

“Vetëm firmat në sektorët që mbizotërohen nga investimet e huaja direkte, si veshje, lëkurë, shërbime ndërtimi dhe mbështetje biznesi janë më të mëdha se mesatarja e BE-së” (Banka Botërore, 2019). Së dyti, të kesh shumë NVM që veprojnë në aktivitete me produktivitet të ulët si shërbimet dhe tregtia, konsiderohet si një tjetër simptomë e keqe, që çon në deindustrializim të parakohshëm. Me kalimin e kohës, politikëbërësit kuptuan se zgjerimi i produktivitetit

në Shqipëri kërkonte një sektor më dinamik NVM-sh, që përfshin furnizuesit e inputeve për degët më të mëdha të prodhimit dhe të mallrave të konsumit. Implikimet e kësaj qasjeje i kushtuan një vëmendje të veçantë ringjalljes së NVM-ve, veçanërisht në aspektin e kreditimit të tyre. Megjithatë Banka Botërore ka ofruar një sasi të madhe ndihme monetare për NVM-të në vendet në zhvillim dhe Shqipërinë gjithashtu, në një studim të saj²⁶ pranohet se

Figura 10:

Madhësia mesatare e firmës sipas sektorëve, 2016


Burimi: INSTAT, Anketa Strukturore e Biznesit, Eurostat

26 Identifikimi dhe lehtësimi i rritjes. Roli i Shtetit në dinamikën e ndryshimit strukturor. Lin, Justin Yifu; Monga, Celestin. Dokument pune për hulumtimin e politikave; Banka Botërore (2010).

“nuk vërtetohet një marrëdhënie shkakësore dhe e fortë midis NVM-ve dhe rritjes së të ardhurave për frymë ose zbutjes së varfërisë”.

Këto të dhëna paraqesin një strukturë ekonomike të fragmentarizuar pa ekonomi të shkallës, çka dëshmon një vështirësi reale për të krijuar biznese të mëdha (BM), të cilat janë të nevojshme për ekonomitë që dëshirojnë të transformohen nga ekonomi me të ardhura të mesme në ekonomi me të ardhura të larta. Ky quhet dështimi i madhësisë.

Ka qenë dhe është e vështirë për NVM-të shqiptare të pozicionohen në konkurrencën globale për shkak të mungesës së madhe të burimeve me të cilën përballen ato. Kështu, shumë prej tyre filluan t'i bashkohen zinxhirit global të vlerës duke qëndruar kryesisht në modalitetin fason. Firmat shqiptare nuk kanë kapacitete për të ndërmarrë rreziqe, edhe zhvillimi i tyre mbetet i varur nga kompanitë shumëkombëshe, qofshin këto klientë apo furnitorë të tyre. Kjo mënyrë pjesëmarrjeje në zinxhirin global, pa dyshim ndikoi në një rritje të qëndrueshme në periudhën afatmesme, megjithatë, e ardhmja e firmave është e pasigurt për shkak të konkurrencës në këtë zinxhir me vende të tjera në zhvillim. Kjo është një çështje e rëndësishme për NVM-të shqiptare, sepse ekonomitë tipike me të ardhura të mesme si jona, përballen me problemin e rritjes së nivelit të pagave, të cilat bëhen shumë të larta për aktivitetet tradicionale prodhuese të nivelit të ulët.

“Përvoja e ekonomive të reja industriale tregon se firmat e mëdha janë shumë të nevojshme kur bëhet fjalë për kalimin nga një ekonomi me të ardhura të ulëta në një ekonomi me të ardhura të larta, sepse këto biznese kanë tendencë të përfitojnë nga ekonomia e shkallës dhe janë të pozicionuara më mirë për të përballuar aktivitetet e kërkim-zhvillimit apo edhe të marketingut. Studimet ekonometrike kanë treguar se të kesh një numër të caktuar

firmash të mëdha vendase, veçanërisht më shumë se ai i parashikuar nga madhësia e ekonomisë, është një tregues nëse një ekonomi është e bllokuar apo jo në kurthin e të ardhurave të mesme. Për shembull, Turqia kishte vetëm një kompani globale në listën “Fortune 500” gjatë dy dekadave të fundit, ndërsa numri i këtyre kompanive në Kore dhe Tajvan u rrit përkatësisht nga tre dhe një në fillim të viteve 1990, në katërbëdhjetë dhe tetë në fillim të viteve 2010. Shumë ekonomi në zhvillim (me përjashtim të rasteve të suksesshme të Koresë, Tajvanit dhe Kinës) kanë më pak firma të mëdha produktive krahasimisht me madhësinë e tyre ekonomike dhe nuk arritën të dilnin nga KAM-i²⁷. Mekanizmi me të cilin firmat e mëdha ndihmojnë ritmet e rritjes konsiston në faktin se ato i vendosin selitë qendrore në vendin e tyre të origjinës, vende ku edhe zhvillojnë shërbimet e kërkim-zhvillimit dhe të marketingut, të cilat janë aktivitete me vlerë të shtuar më shumë sesa prodhimi apo montimi, që mund të kryhen edhe në degët jashtë. Skenari optimal do të ishte të kishim një numër sado të vogël firmash të mëdha të klasit botëror për të nxitur rritjen ekonomike dhe për të udhëhequr inovacionin, përveç një numri të konsiderueshëm NVM-sh, të cilat, më shumë sesa si krijuese, shërbejnë si përhapëse të rritjes ekonomike, duke krijuar vende pune. Pyetja që shtrohet është: si mund të promovohen dhe të zhvillohen firmat e mëdha në një ekonomi kaq të fragmentarizuar?

Një çelës për përgjigjen mund të merret duke shqyrtuar përvojën e kaluar të vendeve në zhvillim, ku firmat e mëdha kanë tendencë të marrin formën e grupeve të biznesit. Granovetter-i (1995)²⁸ e përkufizoi grupin e biznesit si një koleksion firmash të lidhura së bashku zyrtarisht ose jozyrtarisht, që karakterizohet nga një nivel i ndërmjetëm lidhjeje; kjo do të thotë që firmat nuk janë të lidhura as nga aleanca strategjike afatshkurtra dhe as nuk janë të konsoliduara ligjërisht në një njësi të vetme. Me fjalë të tjera, një grup biznesi nuk është një person juridik nëse nuk ka një kompani përfaqësuese të grupit.

27 Arti i arritjes ekonomike: Barrierat, devijimet dhe tejkallimet në sistemet e inovacionit - Keun Lee Cambridge University Press, 2019.

28 Rast i rishikuar: Grupet e biznesit në ekonominë moderne. Mark Granovetter. Ndryshimet industriale dhe korporative, vëll. 4, nr. 1, (1995).

5

NJË POLITIKË INDUSTRIALE PËR SHQIPËRINË

“Duke perifrazuar Tolstoin: Ekonomitë e lumtura janë të gjitha njësoj; çdo ekonomi e palumtur është e palumtur në mënyrën e vet.” (Cherif dhe Hasanov, 2019) Sipas këtij përshkrimi, ekonomia shqiptare është e pakënaqur në mënyrën e vet. Zhvillimi ka të bëjë me transformimin strukturor të ekonomisë. Kjo qasje ka tri dimensione kryesore: diversifikimin e ekonomisë, rritjen e sofistikimit të produkteve dhe shërbimeve dhe transferimin e burimeve (si punën, ashtu edhe kapitalin) drejt aktiviteteve më produktive të ekonomisë. Vetëm kështu mund të arrihen paga të larta dhe punë të mira. Arsyeja përse është e nevojshme një politikë industriale është nevoja për ta përshpejtuar këtë proces nëpërmjet ndërhyrjes së qeverisë²⁹. Tre parametrat kryesorë kërkohet të trajtohen me anë të politikës industriale: rritja e produktivitetit, sofistikimi apo thjesht rritja e nivelit të eksportit³⁰.

Çelësi i suksesit për të rritur në mënyrë të qëndrueshme produktivitetin është trajtimi i dështimeve që përshkruam më sipër. Deri tani qeveritë shqiptare kanë përdorur marshin më të ulët, atë të “zvarritjes së kërmillit”. Siç shpjegoam edhe më sipër, “Zvarritja e kërmillit”, është një qasje graduale, e cila përdoret për të zgjidhur kryesisht dështimet në politikat qeveritare dhe disa nga dështimet e tregut” (Ramalingam, 2013, 219). Ajo nuk konsiston në ndryshime rrënjësore dhe përgjithësisht përfshin rregullimin e çekuilibrave, duke siguruar stimuj për firmat private që veprojnë në sektorë të caktuar (siç janë stimujt fiskalë të ofruar për kompanitë e IT-së në vitin 2018), ngritjen e agjencive promovuese të eksportit, të investimeve të huaja apo investimeve strategjike etj. Shumë politika standarde të ndjekura deri tani bien nën këtë kategori. Ato mund të ndikojnë në një rritje afatmesme të nivelit të eksportit, por jo në ndryshimin cilësor të portofolit të tij.

Shqipëria duhet të tentojë drejt qasjes së “kërcimeve të gjata”, ose ndryshe “të evolucionit me hope” (Ramalingam

29 Zhvillimi dhe politika industriale moderne në praktikë, çështjet dhe përvojat lokale - CO-Publication ADB dhe Edward Elgar (2015).

30 Kthimi i politikës që nuk duhet emërtuar: Parimet e politikës industriale. Reda Cherif dhe Fuad Hasanov, FMN (2019).

2013, 220). Kjo qasje shkon përtej masave standarde të ndërhyrjes. Ajo tenton të dalë jashtë sektorëve të avantazheve krahasuese, të cilat qeveritë lehtësisht përpiqen t’i promovojnë. Edhe argumentet e Hausmann-it (2015b) mbi ngritjen e aftësive prodhuese në industritë ekzistuese, për të kaluar pastaj në industri të ngjashme, por më të avancuara teknologjiksht përbëjnë një qasje graduale, ndërsa identifikimi i mundësive të reja të diversifikimit, do të ishte më afër qasjes “së kërcimit”. Për shembull, Malajzia ka dëshmuar rritje pozitive të produktivitetit dhe përmirësim në sofistikimin e eksporteve, por risi të kufizuara. Qasja e saj zhvillimore mund të klasifikohet si “kërcim i gjatë”.

Megjithatë qasja më frytdhënëse do të ishte e ashtuquajtura “udhëtim në hënë”, e cila do të kërkonte krijimin e industrive të reja dhe sigurimin e gjithë përbërësve të nevojshëm për të ndihmuar firmat vendase të rriten dhe të eksportojnë përtej sektorëve ekzistues ku vendi paraqet avantazhe krahasuese. Kjo qasje kërkon një vizion afatgjatë, si dhe aftësi për të marrë rreziqe. Në këtë qasje shteti luan rolin e “dorës drejtuese” në zhvillim, duke mos e lënë atë vetëm në “dorën e padukshme të tregut”. Nga shumë ekonomistë është përkufizuar si një qasje e “orientuar drejt misionit”, e cila sfidon shtetin duke vendosur para tij kërkesa shumë komplekse që shkojnë përtej rregullimit të dështimeve të tregjeve aktuale. Kjo qasje kërkon nga shteti trajtimin e sfidave teknologjike dhe shoqërore. Mrekullitë aziatike kanë ndjekur këtë qasje dhe kanë përjetuar rritje të lartë produktiviteti, rritje të sofistikimit të eksportit dhe investime të larta në inovacion.

5.1. POLITIKA INDUSTRIALE KA TË BËJË ME PRODHIMIN DHE SHËRBIMET E SOFISTIKUARA

Tradicionalisht, kur mendojmë për politikën industriale, në mendje na vjen prodhimi. Por politika industriale nuk ka të bëjë vetëm me industrinë ose prodhimin në vetvete. Ndërsa ekonomia botërore po kthehet gjithnjë e më shumë drejt shërbimeve, është e qartë se nevojat janë për politika industriale të cilat trajtojnë apo ushqejnë zhvillimin e aktiviteteve të sofistikuara ekonomike, duke përfshirë,

Figura 11:
Struktura ekonomike sipas sektorëve në përqindje, 2010–2018




Burimi: INSTAT

por pa u kufizuar vetëm te prodhimi. Edhe pse industrinë prodhuese kanë përjetuar rritje të lartë të produktivitetit dhe për dekada të tëra kanë shfaqur konvergjencë të pakushtëzuar me rritjen e të ardhurave për frymë, duke u bërë faktori kryesor për mbështetjen e rritjes, sot politika industriale nuk mund të orientohet më si prodhimi kundrejt shërbimeve, por ajo duhet të orientohet drejt produkteve dhe shërbimeve të sofistikuar.

Në pikëpamjen tonë, Shqipëria ka përjetuar një deindustrializim të parakohshëm. Pas vitit 1990, Shqipëria u shndërrua në ekonomi shërbimi pa kaluar në një proces të plotë industrializimi. Me aktivitetin anemik prodhues në Shqipëri, filloi debati nëse Shqipëria duhet të vazhdojë ende prodhimin apo të hidhet drejt shërbimeve. Ekonomistët argumentojnë se shërbimet “moderne” mund të jenë një katalizator për rritjen. Për më tepër,

Figura 12:
Eksportet e Shqipërisë në vitet 2016–2020



Burimi: INSTAT


studimi i Hallward-Driemeier-it dhe Nayyar-it (2017) na sugjeron që “karakteristikat kryesore të prodhimit, si tregtueshmëria, ekonomia e shkallës, inovacioni dhe aftësia për të mësuar duke punuar janë karakteristika të dukshme edhe te shërbimet, kështu që nuk ka arsye përse shërbimet të mos ofrojnë konvergjencë të pakushtëzuar, nëse ofrojnë vlerë të shtuar”. Në të njëjtin përfundim arrin edhe FMN-ja (2018), e cila propozon që shërbimet mund ta zëvendësojnë prodhimin si një motor i rritjes në të ardhmen, pasi kalimi nga prodhimi në shërbime nuk ka pse të sjellë doemos rritje më të ulët të produktivitetit. Ndonëse një argument tjetër në favor të shërbimeve mund të rrjedhë nga fakti se pjesa më e madhe e strukturës së prodhimit janë zakonisht shërbime, në shumë raste, struktura e eksportit do të jepte një pamje të ndryshme. FMN-ja (2018) arrin në konkluzionin se dy lloje shërbimesh: transporti dhe telekomunikacioni, ndërmjetësimi financiar dhe shërbimet e biznesit kanë tendencë të shfaqin rritje të produktivitetit të punës të ngjashëm ose më të lartë edhe se prodhimi, duke shfaqur sjellje të konvergjencës së pakushtëzuar³¹. Këtu përfshihet transporti tokësor, ujor, ajror, postë-telekomunikacioni, ndërmjetësimi financiar,

sigurimi, pensionet dhe shërbimet e biznesit, si marrja me qira e makinerive dhe pajisjeve, softueret dhe përpunimi i të dhënave, K&ZH-të dhe shërbimet profesionale.

Megjithatë, është e vështirë të përcaktohet nëse këto shërbime do të ishin të mjaftueshme për rritje të qëndrueshme dhe krijim të punësimit në plan afatgjatë, pasi, sipas matësit të sofistikimit, shumica e shërbimeve që përfshihen në transport dhe komunikim, ndërmjetësim financiar dhe shërbime biznesi vështirë të konsiderohen “të sofistikuara”. Ky konkluzion rrjedh nga disa arsye. Së pari, nuk është i qartë përcaktimi i vlerës së shtuar në shumë prej këtyre industrive. Është e vështirë të bëhet një ndarje me thikë nëse vlera e shtuar e tyre është thjesht fitimi i lartë si “kërkues qiraje”, pozicionet monopol apo kontributi “i vërtetë” në ekonomi. Së dyti, për vendet e vogla si Shqipëria, këto kategori shërbimesh mund të mos jenë aq të lehta për t’u zgjeruar dhe tregtuar në masë. Kështu që mbështetja e rritjes afatgjatë nga ana e tyre bëhet e pamundur. Për shembull, industria e ndërmjetësimit financiar kërkon aftësi dhe paguan paga të larta, por nuk mbështet punësimin në shkallë të gjerë. Sektori bankar shqiptar është rreth 3,2% e PBB-së dhe ka rreth 6 950 të punësuar, ka formën e një oligopoli dhe ka pak ose aspak shtysë për sofistikim të mëtejshëm, për shkak të tregut të vogël që mungon. Në

31 Të ndërtojme dhe të ndajmë të ardhmen. FMN, 2018

Figura 13:

Ndikimi i turizmit në eksporte, 2000–2015

këtë kontekst, këto lloj industrish pa dyshim e mbështetin rritjen ekonomike në periudha të shkurtra dhe afatmesme, duke u konsideruar si “fitore të shpejta”.

I njëjti konkluzion mund të arrihet edhe për një shërbim tjetër të rëndësishëm në Shqipëri ku do të mbështetet rritja afatgjatë, që është turizmi. Industria e turizmit në Shqipëri është shpallur një sektor strategjik për rritjen dhe punësimin. Sipas Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit, kontributi i përgjithshëm i udhëtimit dhe turizmit në PB-në totale në vitin 2017 ishte 26,2%. Po këtë vit, sektori gjithashtu mbështeti drejtpërdrejt 93 500 vende pune (7,7% të punësimin të përgjithshëm). Kontributi i përgjithshëm i udhëtimit dhe turizmit gjeneroi 54,2% të eksporteve të përgjithshme në vitin 2017. Parashikimet për vitin 2019 tregojnë se numri i vizitorëve të huaj pritej të rritej në 6,4 milionë, nga 5,9 milionë që ishin në 2018. Siç tregojnë të dhënat, turizmi ka gjeneruar disa të ardhura nga eksporti, rritje dhe punësim. Por prapëseprapë, pyetja që shtrohet është: a mund të jetë kjo industri një mbështetëse afatgjatë e rritjes ekonomike në Shqipëri? Eksperienca botërore dhe studimet empirike sugjerojnë se turizmi gjithashtu konsiderohet si “fitore e shpejtë”, kështu që vështirë se mund të cilësohet si çelës për rritjen afatgjatë.

Një rritje në eksportet e sektorit të turizmit me 8% (e matur në një mostër statistikore me mbi 80 vende gjatë

viteve 1980–1990) mund ta rritë ekonominë mesatarisht me gjysmë pikë përqindjeje në vit (Arezki, Cherif, dhe Piotrowski, 2009). Eksperienca botërore tregon se specializimi në turizmin tradicional sjell përfitime të kufizuara në rritje, për disa arsye. Së pari, për të gjeneruar rritje, vendi duhet të tërheqë një numër edhe më të madh turistësh, pasi të ardhurat reale për një turist janë kryesisht konstante. Numri më i madh i turistëve do të rriste në mënyrë eksponenciale koston e shërbimeve publike, si siguria, shërbimet komunale dhe menaxhimi i mbeturinave. Së dyti, turizmi përfshin aktivitete me produktivitet të ulët si tregtia dhe hoteleri-restorantet. Në këtë mënyrë, edhe përzgjedhja e turizmit si një sektor strategjik i përshtatet marshit më të ulët të politikës industriale të ndjekur nga Shqipëria deri më sot (“zvarritjes së kërmillit”), por nuk mjafton për të kaluar në një marsh tjetër.

Përfundimisht, duhet të pranojmë se shërbimet e sofistikuar që sjellin përfitime në afate të gjata lidhen me shërbimet shkencore, kërkimore e zhvillimore dhe shërbimet profesionale kundrejt biznesit. Pra, shërbimet e sofistikuar mund të mbështetin rritjen e produktivitetit dhe punësimin, në fakt, ato lidhen në mënyrë të tërthortë me industrinë prodhuese.

Pra, elementi i parë kryesor i një strategjie rritjeje është i drejtpërdrejtë – prodhoni produkte dhe shërbime të sofistikuar për të kapur vendet e përparuar, por jo

domosdoshmërisht të njëjtat produkte. Por ka edhe një element të dytë po aq të rëndësishëm, që lidhet me prodhuesin e produktit apo të shërbimit të sofistikuar, i cili duhet të jetë pazgjdhshëmrisht firma vendase. Vetëm në këtë rast do të ishte i mundur krijimi i teknologjisë. Formimi dhe zhvillimi i novatorëve vendas duhet të jenë në qendër të politikës industriale.

5.2. NGA T'IA FILLOJMË?

Identifikimi i sektorëve – Një ekonomi, për t'u bërë konkurruese dhe për t'u zhvilluar më tej, duhet të angazhohet fort në aktivitet tregtar me ekonomitë e tjera, aq më tepër kur është e vogël dhe nuk mund të mbështetet vetëm në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve për tregun vendas. Pra, për një ekonomi të vogël është e rëndësishme të identifikohen produktet dhe sektorët që 1) janë në përputhje me strukturat e saj aktuale të avantazhit konkurrues, si dhe 2) të identifikohen sektorët që janë duke u rritur në mënyrë dinamike në të gjithë globin, për shkak të tendencave aktuale dhe të ardhshme të konsumit. E para është analizë nga krahu i ofertës, që identifikon se cilat janë kompetencat kryesore të ekonomisë vendase, ndërsa e dyta përfaqëson një analizë nga ana e kërkesës, që tregon nëse ka një treg në rritje për produktet e industrive të veçanta.

Literatura mbi politikën industriale thotë se nuk ka asnjë metodë të provuar që mund të konsiderohet e përshtatshme për të gjitha vendet dhe ekonomitë. Teoria e tregtisë neoklasike na këshillonte të maksimizim mirëqenien duke alokuar burimet (punën dhe kapitalin), si edhe të rritnim specializimin në ato produkte ku ekonomia kishte avantazhe krahasuese. Sidoqoftë, ky rekomandim është shumë i përgjithshëm dhe statik. Për më tepër, duhet thënë se kjo qasje nuk kërkon një strategji apo metodologji të përzgjedhjes së sektorëve që duhen promovuar apo që kanë nevojë për politika mbështetëse, pasi ajo ngrihet mbi supozimin neoklasik se në një ekonomi tregu janë forcat e tregut ato që përzgjedhin sektorin dhe përcaktojnë alokimin e burimeve në mënyrë efikase pa ndërhyrjen e qeverisë. Duke u mbështetur te përzgjedhja e sektorëve dhe alokimi i burimeve bazuar vetëm në forcat e tregut, Shqipëria, krahasuar edhe me gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, ka një Indeks të Kompleksitetit Ekonomik (IKE) dhe vlerë oportune (*Opportunity value*, ose OV) nën mesataren botërore.

Sot, me interesin e ripërtërirë në politikën industriale, një numër autorësh kanë sugjeruar metodologji për të ndihmuar vendet në përzgjedhjen e sektorëve. Ne mund të këshillojmë në veçanti "Kuatrin e identifikimit dhe lehtësimit të rritjes", të studiuesve Lin dhe Monga (2011), dhe "Teorinë e hapësirës së produktit" të Hidalgo-s (2007). Sipas këndvështrimit tonë, këto dy qasje janë plotësuese dhe mund të përdoren si brenda agjencive qeveritare që hartojnë dhe zbatojnë planet e zhvillimit, ashtu edhe në diskutimet me sektorin privat. Të dyja teknikat bazohen në arsyetime të shëndosha dhe janë pika të forta fillestare.

Kuadri i identifikimit dhe lehtësimit të rritjes thekson se vendet duhet të synojnë sektorë që janë në përputhje me avantazhin e tyre krahasues, dhe vendet me të ardhura të mesme duhet të studiojnë përvojat e vendeve që sot kanë të ardhura për frymë dy deri në tri herë më të larta, dhe më pak ose aspak ngjashmëri në strukturën ekonomike. Teoria e hapësirës së produktit bazohet në idenë se produktet që një vend eksporton duhet të mishërojnë aftësitë konkurruese të atij vendi. Mesazhi është i qartë: Shqipëria duhet të synojë sektorë të cilët tashmë kanë një avantazh konkurrues, por në të njëjtën kohë duhet të përzgjedhë sektorë potencialë të rinj, duke tentuar të prodhojë produkte me vlerë të shtuar më të lartë. Kështu, një studim i fundit i OECD-së (2019)³² tregon se "eksportet shqiptare gjenden kryesisht në periferi të hapësirës së produkteve. Shqipëria ka avantazh krahasues të dukshëm dhe të qëndrueshëm (RCA) në veshje dhe produkte lëkure (10% e eksporteve të përgjithshme shqiptare). Segmente të tjera me avantazh krahasues janë mineralet (kryesisht nafta e papërpunuar, e cila përbën 8% të eksporteve të vendit, por edhe xeherorët, kromi), produktet agro-shqimë (perimet, bimët medicinale dhe përpunimi i peshkut) dhe metalet (shufrat e hekurit të papërpunuara dhe ferroaliazhet)". Sidoqoftë, të gjitha këto janë kategori produktesh me një Indeks të ulët të Kompleksitetit të Produktit (ICP). I njëjti studim sugjeron që Shqipëria të diversifikojë shportën e saj të eksportit duke zgjeruar aftësitë e veta. Vendi ynë eksporton rreth 225 produkte të tjera, ku nuk ka krijuar një avantazh konkurrues, por që shfaqin një përfitim të mundshëm; kështu, sipas këtij studimi, Shqipëria ka potencial për ta rritur Indeksin e Kompleksitetit Ekonomik, i cili mund të krijojë konvergencë afatshkurtër me rritjen ekonomike të Shqipërisë.

Por vetëm analiza e ofertës nuk është e mjaftueshme, pasi rritja ekonomike e afatgjatë nuk mund të mbështetet në produkte dhe shërbime që mund të rezultojnë me rënie për sa i përket kërkesës, e cila nxitet nga tregjet ndërkombëtare dhe të vendit. Janë pikërisht sektorët që prodhojnë produktet dinamike, ose ato për të cilat pritet të rritet kërkesa globale, ata që mund të mbështetin rritjen afatgjatë.

Kështu, një strategji industriale efektive duhet të krijojë një ekuilibër midis përzgjedhjes së produkteve me përfitim afatshkurtër dhe produkteve dinamike (afatgjata). Janë pikërisht këto të fundit të cilat mundësojnë rritjen e stokut të njohurive në ekonomi, duke hapur rrugën drejt produkteve gjithnjë e më komplekse. Duke identifikuar sektorë apo produkte premtuese, është e mundur të zhvillojmë sektorë që kanë një potencial më të madh se mesatarja për të kontribuar drejt transformimit, por sërish, vetëm identifikimi nuk mjafton.

Një kriter i rëndësishëm që duhet marrë parasysh në politikën industriale lidhet me madhësinë e barrierave të

32 Europa globale Juglindore: Çlirimi i potencialit të transformimit për rritje në Ballkanin Lindor, OECD (2019).

Tabela 3:

Numri i produkteve premtuese sipas kategorive të produkteve në Shqipëri (2016)

Kategoria e produktit (HS1)	Numri i produkteve
Metalet bazë dhe artikujt prej metaleve bazë	37
Tekstile dhe artikuj tekstili	28
Makineri, pajisje mekanike dhe pajisje elektrike	28
Produktet ushqimore dhe duhani	19
Industritë kimike ose të llojeve të ngjashme	19
Guri, materialet e ndërtimit, të qelqit dhe qelqi	19
Artikuj druri, artikuj prej druri dhe letre	18
Plastika, goma dhe artikujt prej tyre	15
Perime	11
Automjete dhe pajisje transporti	9
Kafshët dhe pajisjet e transportit	8
Të ndryshme	8
Produkte minerale	4
Lëkura të papërpunuara dhe lëkura prej gëzofi lëkure	1
Këpucë dhe kapele	1

Burimi: Llogaritje të OECD-së bazuar në CEPII (2019 [5]), CEPII BACI, Baza e të Dhënave e Tregtisë Botërore

hyrjes në tregjet globale. Sektorët të cilët bazohen në burime natyrore priren të jenë sektorët me barriera më të ulëta për hyrjen krahasuar me gjithë sektorët e tjerë të prodhimit, në varësi kjo të burimit natyror dhe të trashëgimisë historike³³. Ky rezultat është i konfirmuar edhe nga analizat e ofertës së produkteve ku Shqipëria ka avantazhe konkurruese.

Së dyti, sektorët ose segmentet që operojnë në bazë të teknologjive me cikël të shkurtër kanë barriera të ulëta hyrjeje krahasuar me sektorët të cilët operojnë në teknologji me cikle të gjata me barriera të larta hyrjeje, të cilat janë në fakt shenja dalluese të ekonomive të përparuara. Koha e ciklit teknologjik është përcaktues i rëndësishëm i shpejtësisë teknologjike. Studimet e përcaktojnë kohën e ciklit teknologjik bazuar në shpejtësinë e ndryshimit ose të vjetërimit të teknologjisë me kalimin e kohës. Ky variabël pasqyron një atribut të rëndësishëm të njohurive që mund të vjetërohen me kalimin e kohës. Në këtë drejtim, disa njohuri vjetërohen shpejt, ndërsa të disa të tjera kërkojnë një periudhë më e gjatë për t'u vjetëruar. Shpejtësia e vjetërimit ndikon në shanset e "arritjes" së më të përparuarve nga ana e vendeve në zhvillim. Nëse njohuritë janë të qëndrueshme,

atëherë përvetësimi i njohurive dhe teknologjisë në atë fushë kërkon më shumë kohë, ndërkohë që, nëse njohuritë janë kalimtare, atëherë vendet në zhvillim nuk kanë nevojë të zotërojnë teknologjitë e vjetra. Prandaj, vende si Shqipëria mund të arrijnë zhvillim më të madh duke synuar dhe duke u specializuar në sektorë apo segmente që lidhen me cikle të shkurtra teknologjike. Në sektorë të tillë, dominimi i vendeve të zhvilluara shpesh ndërpritet, dhe shfaqja e vazhdueshme e teknologjive të reja mund të gjenerojë oportunitete të reja për vendet në zhvillim, pasi starti është i njëjtë.³⁴ Kështu që specializimi në sektorët e segmentet me cikle të shkurtra teknologjike jo vetëm ka barriera të ulëta dhe ndikon te rritja e shpejtë, por edhe shoqërohet me më pak përplasje me teknologjitë e vendeve të përparuara, me më pak mosmarrëveshje për të drejtat intelektuale të pronës, me më pak pagesa rente për zotërimin e këtyre të drejtave, me avantazhet e hyrësit të parë, si dhe mundëson diferencim të produktit. Për shembull, sektori i teknologjisë së informacionit ka një cikël më të shkurtër sesa sektorët e prodhimit farmaceutik, në këtë kuptim, risitë e fundit në teknologjinë e informacionit priren të mbështeten më pak në stokun ekzistues të njohurive³⁵.

33 Lebdioui, A., Lee, K. dhe Pietrobelli, C. Ndërfaqja lokale e teknologjisë së huaj, zhvillimi i bazuar në burime dhe politika industriale: Si po i shpëtojnë Kili dhe Malajzia kurthit të të ardhurave të mesme.

34 Shiko Giuliani, Pietrobelli, dhe Rabellotti (2005) dhe Navas-Alemán (2011).

35 Shiko Ernst dhe Kim (2002), si dhe Sturgeon dhe Lester (2004).

Për më tepër, avantazhi i specializimit në sektorët me cikël të shkurtër teknologjik përputhet me marshin “e kërcimit” pasi lejon si vendet në zhvillim edhe ato të zhvilluara t’ia nisin nga i njëjti start. Për sa i përket konkurrencës, para një paradigme të re tekniko-ekonomike, si vendet e zhvilluara, edhe ato në zhvillim vendosen në të njëjtin start. Në këtë përpjekje për të identifikuar sektorët, politikëbërësit duhet të organizojnë grupe pune të përbashkëta publik-privat, që përfshijnë përfaqësues nga sektori privat.

Infomacioni i mbledhur nga sektori privat është kyç në identifikimin e sektorëve. Firmat ekzistuese private dhe sipërmarrësit duhet të pyeten mbi llojet e aktivitetit, fushat teknologjike, fushat me potencial në të ardhmen, mundësitë, rreziqet dhe vështirësitë në lidhje me hyrjen ose fillimet në sektorë të caktuar. Është e rëndësishme të kuptohet se cilat janë fushat e biznesit ku sektori privat sheh një potencial të caktuar tregu, por percepton edhe pasiguri teknologjike, financiare, mjedisore ose

Kutiza 1

KONCEPTI I “BUJQËSISË INTELIGJENTE”

Në botën e sotme të superlidhur, një sasi e madhe të dhënash dhe informacioni përhapet me shpejtësi dhe një aspekt i rëndësishëm është menaxhimi i kësaj njohurie, për të marrë vendimin e duhur në kohën dhe vendin e duhur.

Shembulli më domethënës në këtë kuptim janë “qytetet inteligjente”, një koncept i zhvillimit urban për të integruar teknologjitë e TIK-ut dhe të Internetit të Objekteve (IoT), duke krijuar një mjedis të sigurt për të menaxhuar pasuritë e një qyteti. Këto asete përfshijnë sistemet e informacionit të institucioneve të qeverisjes vendore, shkollat, bibliotekat, sistemet e transportit, spitalet, uzinat, rrjetet e furnizimit me ujë, menaxhimin e mbetjeve, zbatimin e ligjit dhe shërbime të tjera komunitare. Një “qytet i inteligjent” promovohet që të përdorë informatikën dhe teknologjinë urbane për të përmirësuar efikasitetin e shërbimeve. TIK-u përdoret për të përmirësuar cilësinë e jetës, performancën dhe ndërveprimin e shërbimeve urbane, për të reduktuar kostot, për të përmirësuar shpërndarjen dhe menaxhimin e burimeve dhe për të përmirësuar ndërveprimin midis të gjithë aktorëve, duke përfshirë qytetarët, palët e interesuara dhe qeverinë.

Në këtë kontekst, bujqësia duhet të bëhet gjithashtu SMART për të kapërcyer sfidat e sotme, dhe modeli IoT (që po evoluon drejt Internetit të Gjithçkaje (IIoE)) mund të përfaqësojë arkitekturën e duhur për të riorganizuar bujqësinë dhe të gjitha disiplinat dhe teknologjitë e përfshira në konceptin SMART. Kryesorja e një zhvillimi të tillë është maksimizimi i produktivitetit. Sipas hulumtimeve të fundit, sfida kryesore e IoT-së për bujqësinë është dyfishimi i prodhimit global bujqësor deri në vitin 2050. Kur të zhvillohet, vlerësohet dhe zbatohet plotësisht, ai do të ofrojë mundësi për të aktivizuar nënfushat dhe ndoshta vendimet specifike në kohë reale. Ai do të ofrojë aftësi për të mbledhur, siguruar dhe ndarë grupe të dhënash me intensitet të lartë, që mund të filtrohen ose të përpunohen me llogaritjen e skajshme ose në terren, apo me sisteme kompjuterike me performancë të lartë në platformat cloud, duke përdorur algoritme inovatore, inteligjencën artificiale dhe mësimin e makinerive, duke analizuar sasi të mëdha të dhënash dhe duke prodhuar me shpejtësi rekomandime për fermën pothuajse në kohë reale (Fries, 2018) (Annamaria Castrignano, 2020).

Bujqësi inteligjente do të thotë të adoptosh një vizion të ri të sektorit të prodhimit parësor, ku proceset e zhvillimit bazohen në integrimin e teknologjive TIK dhe IoT në një mënyrë të sigurt për të menaxhuar asetet rurale. Lloje të ndryshme sensorësh lidhen për të krijuar një rrjet rural të lidhur me rrjetin e internetit. Të dhënat e transmetimit në kohë reale ruhen në baza të të dhënave komplekse, që përmbajnë të gjitha njohuritë e nevojshme për karakteristikat e tokës. Programet

inteligjente të lidhura me bazën e njohurive shërbejnë për të marrë vendime në kohë reale, duke dërguar mesazhe veprimi në sistemin e automatizuar ose sugjerime për fermerin.

Një komponent kyç i bujqësisë inteligjente është procesi i “vendimmarrjes”, që përdor modele dinamike të cilat evoluojnë sipas përvojës së mbledhur me kalimin e kohës. Kjo lejon zgjerimin e njohurive për një produkt bujqësor në bazë të dëshmime empirike të mbledhura, në mënyrë që të përditësohen si rrjedhojë praktikat më të mira.

Aplikacioni *Smart Farming*

Koncepti i bujqësisë inteligjente përbëhet nga sa vijon:

- rrjetet e sensorëve pa fije (WSN) (IoT);
- shkrirja e informacionit dhe e të dhënave;
- inteligjenca mbështetëse e vendimeve dhe
- aktivizuesit për aplikimet e hyrjeve.

Të dhënat e mbledhura nëpërmjet sensorëve të shumtë ruhen dhe përpunohen më vonë. Integrimi i sensorëve pa fije me aplikacione bujqësore për celularë dhe platforma cloud ndihmojnë në mbledhjen e informacionit përkatës në lidhje me kushtet mjedisore mbi variabla të ndryshëm që lidhen me temperaturën, reshjet, lagështinë, shpejtësinë e ajrit, infektimin nga dëmtuesit, përmbajtjen e humusit të tokës ose lëndët ushqyese të tokës bujqësore, të cilat mund të përdoren për të marrë vendime të qarta që synojnë përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së prodhimit, si dhe minimizimin e rreziqeve dhe humbjeve. Monitorimi i fushës ose i të korrave, i bazuar në aplikacion, gjithashtu ndihmon në menaxhimin e të lashtave në vende të shumta. Për shembull, fermerët tanimë mund të zbulojnë se cilat zona janë plehëruar (ose kanë mbetur gabimisht pa u plehëruar), ose kanë nevojë të ujitin, dhe të vlerësojnë ndikimin e praktikave të tyre në rendimentet e ardhshme.

Megjithëse, PBB-ja e Shqipërisë në vitin 2019 përbëhej kryesisht nga shërbimet (që përbënin 48,6% të PBB-së, sektori i bujqësisë ende luan një rol të rëndësishëm në PBB-në e vendit (18,6%) dhe “forca punëtore përbën 37,8% të punësimit total në 2019. Sektori i bujqësisë ka qenë i dominuar nga pronat e vogla private, që vuajnë nga copëzimi i tokës, aksesit i kufizuar në financa për bizneset që veprojnë në sektorin e bujqësisë dhe produktiviteti i ulët. Zbatimi i konceptit të bujqësisë inteligjente mund ta çojë në një nivel tjetër sektorin e bujqësisë shqiptare, duke nxitur produktivitetin dhe duke rritur konkurrencën.

Figura: Modeli IoT bujqësor



Annamaria Castrignano_ Gabriele Buttafuoco_ Raj Khosla_ Dimitrios Moshou_ Abdul Mouazen_ Olivier Naud – Interneti i Objekteve në Bujqësi dhe mbështetja e vendimeve për Bujqësinë Inteligjente- (Elsevier 2020)

rregullatore. Firmat private mund ta dinë se ku janë tregjet e ardhshme, por mund të jenë të pasigurta në lidhje me aftësinë e tyre për të zhvilluar teknologjitë e nevojshme dhe të duhura në mungesë edhe të fondeve për shpenzime kërkim-zhvillimi dhe marketingu.

Si përfundim, ajo që duhet të synohet nga procesi i identifikimit janë dy lloje përmirësimesh: hyrja në industri të reja dhe përmirësimi në segmentet me vlerë të lartë në industrinë ekzistuese, duke arritur kështu një përmirësim të strukturës së përgjithshme industriale.

Megjithëse qëllimi i këtij punimi nuk është identifikimi i sektorëve nga të dhënat dhe kërkimi që kemi kryer, mendojmë se ide novatore për Shqipërinë mund të jenë kalimi në shërbimet e IT-së ose “bujqësia inteligjente”, duke anashkaluar përmirësimet në produktet apo teknologjitë ekzistuese. Bujqësia po njihet gjithnjë e më shumë si një sektor i teknologjisë së lartë sesa si një industri tradicionale që i përket së ashtuquajturës “industri e gjashtë”, e cila është një kombinim i industrive parësore, dytësore dhe terciare. Industria e gjashtë është e kombinuar me IT-në ose teknologjitë digjitale, ndërsa përgatitet për përfitimet e inovacioneve të reja që janë shoqëruar vitet e fundit me 4IR. Një model për këtë është Holanda, e cila po udhëheq “bujqësinë inteligjente” dhe produktet e qumështit. Në vitin 2019, Holanda eksportoi 94,5 miliardë euro mallra bujqësorë, që përbënin rreth 17% të eksporteve të përgjithshme. Kjo e bën sektorin bujqësor holandez eksportuesin e dytë më të madh të produkteve bujqësore në botë, pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Bujqësia inteligjente mund të jetë një sektor më tërheqës për IHD-të. Një sektor tjetër premtues në një treg global me potencial të madh janë shërbimet e ofruara nga Teknologjia e Regjistrimit të Shpërndarë. Në vitin 2019, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ligj për asetet virtuale, i cili synon të rregullojë aktivitetet e funksionimit të platformave të tregtimit të letrave me vlerë digjitale. Edhe pse industria është në faza pioniere në gjithë botën, dhe Shqipëria është përpjekur të ofrojë disa siguri ligjore për këtë lloj aktiviteti, akoma mungon infrastruktura e nevojshme për sektorin, siç janë sistemet e inovacionit rreth tij dhe fondet për kërkim-zhvillim në këtë fushë. Kutia më poshtë përshkruan konceptet e “bujqësisë inteligjente” dhe implikimin e saj në Shqipëri, ku sektori bujqësor luan një rol të rëndësishëm në kontributin e PBB-së (18 %).

Kutia më poshtë përshkruan konceptet e Teknologjisë së Regjistrimit të Shpërndarë dhe potencialin që ajo paraqet për zhvillimet e ardhshme si sektor premtues.

Krijimi i Sistemit Kombëtar të Inovacionit (SKI) – Përtej identifikimit të sektorëve, për të korrigjuar dështimin e aftësive, është e nevojshme që firmave t'u ofrohet mundësi mësimi në mënyrë që ato të rritin aftësitë e tyre inovative. Megjithatë, kultivimi i aftësive në nivel firme nuk përfshin vetëm firmat, por edhe aktorët që i rrethojnë ato. Me fjalë të tjera, mësimi dhe ngritja e aftësive të firmave vendase duhet të plotësohet me tri elemente. Elementi i parë është krijimi një sistemi inovativ që përfshin aktorë të ndryshëm

që ndikojnë në inovacionin dhe aftësitë e firmave vendase (p.sh.: furnizuesit, përdoruesit dhe konsumatorët, universitetet, laboratorët publikë të kërkimit dhe agjencitë qeveritare). Elementi i dytë është prania e mjediseve specifike institucionale (p.sh.: sistemet financiare, normat, rregulloret dhe standardet). Elementi i tretë është sigurimi i lidhjes dhe ndërveprimit midis aktorëve që përbëjnë sistemin.

Eksperiencia ka treguar se zhvillimi i Sistemeve Kombëtare të Inovacionit ka çuar në zhvillimin e inovacionit dhe të performancës më të mirë ekonomike, veçanërisht për vendet në stadin e të ardhurave të mesme. Janë këto sisteme ato që mundësojnë përkthimin e njohurive shkencore në njohuri teknologjike. Në mungesë të tyre, njohuritë shkencore priren të mos komercializohen, por të mbeten në nivel akademik³⁶.

Strategjitë e Inovacionit të shkruara dhe të hartuara në Shqipëri mbështeten vetëm tek i ashtuquajturin model linear i inovacionit që lidh shkencën me inovacionin. Por eksperiencia ka treguar që ky sistem shpesh nuk funksionon, sepse sektorit të shkencës i mungon aftësia për të identifikuar teknologjitë e nevojshme për sektorin industrial. Duke mos i njohur kërkesat e sektorit industrial, sektori i shkencës tenton të fokusohet në kërkimet themelore akademike, të cilat mund të jenë të parëndësishme për nevojat e sektorit industrial. Kështu, përqendrimi vetëm në sektorin e shkencës, pa synuar zhvillimin e sektorit industrial nuk mund të jetë zgjidhje. Gjetjet empirike sugjerojnë se modeli linear i inovacionit që thekson rolin e njohurive shkencore si një input për inovacionin industrial nuk funksionon, veçanërisht kur mungojnë sisteme efektive ose të zhvilluara sa duhet, për të lehtësuar transformimin e njohurive. Kim dhe Lee konstatojnë se njohuritë teknologjike nuk krijohen nga njohuritë shkencore, por nga përpjekjet e firmave për kërkim dhe zhvillim, të cilat janë në mungesë të theksuar në Shqipëri. Një konkluzion i rëndësishëm në këtë kontekst është fakti se pa zbatuar një politikë teknologjike që thekson rolin e kërkim-zhvillimit të kryer në firma dhe pa gjallërimin e sektorit industrial, politikat që theksojnë vetëm shkencën nuk mund të krijojnë përfitime ekonomike të dukshme³⁷.

Subvencionimi për kërkim-zhvillimin – Edhe pse gjithë politika industriale vërtitet rreth zhvillimit të njohurive dhe teknologjive vendase, për vendet në zhvillim njohuritë e huaja janë kritike, pasi, pa to, përpjekja e vendeve në zhvillim shpesh bëhet e rrezikshme, kërkon kohë dhe është e kushtueshme. Zhvillimi i suksesshëm teknologjik për vendet në zhvillim kërkon mbështetjen e qeverisë, së pari në aksesin në njohuritë e huaja. Kanalet e ndryshme të dijës dhe të mësimit përfshijnë mënyra, si: (1) trajnimin në

36 Arti i arritjes ekonomike: Barrierat, devijimet dhe tejkalimet në sistemet e inovacionit. Keun Lee, (2019).

37 Arti i arritjes ekonomike: Barrierat, devijimet dhe tejkalimet në sistemet e inovacionit. Keun Lee (2019).

Kutiza 2

TEKNOLOGJIA E REGJISTRIT TË SHPËRNDARË (DLT), DHE LIGJI I ASETVE VIRTUALE NË SHQIPËRI

Teknologjia e Regjistrit të Shpërndarë (*Distributed Ledger technology*, ose DLT), është një protokoll që mundëson funksionimin e sigurt dhe të decentralizuar të një baze të dhënash digjitale. Thelbi i saj është ndarja e një baze të dhënash ndërmjet shumë pjesëmarrësve njëherësh. Ndryshe nga një regjistër tradicional, i cili kontrollohet nga një burim i vetëm, një regjistër i shpërndarë mund të përditësohet nga shumë pjesëmarrës që hyjnë në bazën e të dhënave nga vende të ndryshme. Secili pjesëmarrës ka akses në një kopje identike të bazës së të dhënave dhe çdo ndryshim pasqyrohet virtualisht në të njëjtën kohë në të gjithë rrjetin. Koncepti i një baze të dhënash të shpërndarë nuk është i ri, por përparësia kryesore e DLT-së është se lejon që informacioni të ndahet në mënyrë të sigurt dhe efikase.

Vetë natyra e një regjistri të decentralizuar siguron mbrojtje ndaj një krimi kibernetik, pasi sulmi mund të realizohet vetëm kur të gjitha kopjet e ruajtura në rrjet sulmohen në të njëjtën kohë. Për më tepër, ndarja dhe përditësimi i njëkohshëm (*peer-to-peer*) i të dhënave e bëjnë të gjithë procesin shumë më të shpejtë, më efektiv dhe më të lirë.

Kriptomonedha është pa dyshim shembulli më i përhapur i DLT-së në praktikë, por zbatimet e mundshme të teknologjisë shtrihen edhe më gjerë. DLT-ja ka potencial të madh për të revolucionarizuar punën e qeverive, të institucioneve dhe korporatave. Kjo teknologji mund t'i ndihmojë qeveritë me mbledhjen e taksave, lëshimin e pasaportave, regjistrat e pronësisë dhe të licensave, regjistrat e Sigurimeve Shoqërore, si dhe procedurat e votimit. Teknologjia po bën përparime në industri, si financa, muzika dhe argëtimi, arti dhe po shtrihet në zinxhirët e ndryshëm të furnizimit të mallrave.

Bazuar në vlerësimet e "Gartner, Inc."-së, vlera e shtuar e biznesit të DLT-së do të rritet në pak më shumë se 176 miliardë dollarë deri në vitin 2025, për të kaluar 3,1 trilionë dollarë deri në vitin 2030.

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar në vitin 2019 Ligjin për Letrat me Vlerë Virtuale, i cili synon të rregullojë aktivitetet e mëposhtme:

- promovimin, shitjen dhe shpërndarjen e letrave me vlerë digjitale (ICO);

- funksionimin e platformave të tregut dytësor që tregtojnë letra me vlerë digjitale; dhe
- ofrimin e shërbimeve të investimit në lidhje me letrat me vlerë digjitale.

Ndonëse konsiderohet si pioniere në këtë sektor, dhe po përpqet të ofrojë siguri juridike për aktivitete të caktuara të letrave me vlerë digjitale, të cilat nuk ofrohen akoma gjerësisht në Europë dhe në botë, Shqipëria ka mangësi në infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e duhur të DLT-së. Së pari, përdorimi i kësaj teknologjie padyshim sjell pasiguri për publikun, dhe deri diku zbutja e këtyre pasigurive është detyrë e qeverisë. Kështu që detyra e mbikëqyrjes së subjekteve të përfshira në përdorimin e kësaj teknologjie kërkon një panel ekspertësh të kualifikuar me kompetenca në fusha të ndryshme, duke përfshirë teknologjitë inovative, shkencën kompjuterike, kriptografinë, shërbimet financiare, auditimin, kontabilitetin, ligjin dhe rregullimin. Së dyti, për të zhvilluar këtë risi teknologjike, duhen krijuar dhe transmetuar njohuritë e nevojshme në ekonomi. Një autoritet apo agjenci inovacioni, duhet të ishte përgjegjëse për politikën e inovacionit të vendit, duke përfshirë dhe DLT-në. Ky ent publik i pavarur dhe i paanshëm duhet të operonte në të mirë të ekosistemit shqiptar të inovacionit dhe ekonomisë shqiptare, si ofruesi inovativ i infrastrukturës teknologjike, si dhe si autoritet rregullues dhe mbikëqyrës. Roli i tij duhet të konsistonte në zhvillimin e burimeve e inovacionit të Shqipërisë, duke krijuar dhe forcuar infrastrukturën dhe kornizën e nevojshme për të mbështetur të gjitha njohuritë në industri. Ai mund të shërbente si pikë qendrore për Sistemin Kombëtar të Inovacionit, ose si institucioni kryesor kryesor i të mësuarit dhe ngritjes së aftësive për firmat vendase që mund të operonin në këtë sektor. Së treti, për të intensifikuar aktivitetet e K&ZH-së në këtë sektor, qeveria duhet t'u ofrojë firmave pinonere stimuj tatimorë me kohë të kufizuar dhe investime bashkëfinancuese.

Elementet e lartpërmendura janë shumë të rëndësishme që Shqipëria të ketë një qasje zhvilluese të sektorit. Pa to, përparimi i inovacionit teknologjik në këtë sektor është thujse i pamundur dhe përfitimet për ekonominë janë të kufizuara.

firmat dhe institutet e huaja, (2) OEM-in, (3) ndërmarrjet e përbashkëta, (4) bashkëzhvillimin me specialistë të huaj të specializuar në firmat e kërkim-zhvillimit, (5) punësimin e shkencëtarëve ose të inxhinierëve, (6) përpjekjen për kthimin e trurit në vend, (7) bashkëpunimin me qendrat e kërkim-zhvillimit jashtë, (8) aleancat strategjike dhe (9) bashkimet dhe blerjet ndërkombëtare (Lee, 2005)³⁸.

Së dyti, financimi është një faktor i rëndësishëm për mbështetjen e firmave vendase. Në Shqipëri, është e vështirë të sigurosh financim për projekte me shkallë të gjerë, pasi institucionet financiare private dhe investitorët hezitojnë të ofrojnë financime afatgjata. Tregjet financiare janë të pazhvilluara dhe Shqipëria nuk ka institucione financiare të specializuara në rreziqet e ndërmjetësimit si "kapitali sipërmarrës" (Shqipërisë i mungon edhe legjislati). Kështu që kërkesa për financim nga ana e

qeverisë është e lartë, shpesh në formën e subvencioneve, të kredisë, apo të tërheqjes së kapitalit privat, të huaj dhe vendas, rreth sektorëve strategjikë.

Së treti, politikëbërësit mund të marrin në konsideratë kompensimin e firmave pioniere në industrinë e identifikuar me stimuj tatimorë të kufizuar në kohë, apo investime bashkëfinancuese. Kjo është një ndihmë që u ofrohet kompanive pioniere për të përballuar eksternalitetet e hyrjes në sektorët e identifikuar. Por është e rëndësishme të theksojmë që stimujt duhet të jenë të kufizuar si në kohë, ashtu edhe në sasi. Për të parandaluar përfitimet e padrejta dhe kapjen politike, qeveria duhet të shmangë stimujt që krijojnë monopol ose shtrembërime të tjera. Për më tepër, stimujt duhet të lidhen me performancën dhe të vlerësohen vazhdimisht kundrejt objektivave të deklaruara.

38 Arti i arritjes ekonomike: Barrierat, devijimet dhe tejkalimet në sistemet e inovacionit. Keun Lee (2019).

6

VËREJTJET E FUNDIT

Siç e theksuam, politika industriale që na nevojitet duhet të trajtojë nevojën për të ushqyer dhe zhvilluar aktivitete të sofistikuar ekonomike, që përfshijnë, por nuk kufizohen në prodhim. Emërtimi “politika industriale” mund të jetë disi çorientues, përdorja e paksa në hije gjerësinë e misionit. Ekzistojnë të tjera alternativa të ngjashme emërtimi, si “politikat e zhvillimit produktiv”, “politikat strukturore të transformimit” ose “politikat e inovacionit”. Ne vendosëm të përdornim “terminologjinë tradicionale”, edhe pse emërtimet e tjera mund të ishin po aq të përshtatshme.

Së dyti, politika industriale e së ardhmes nuk duket të jetë e ngjashme me konceptin tradicional të ekonomiksit për të: politikëbërje nga lart-poshtë, duke synuar sektorët e parazgjedhur dhe duke përdorur një listë standarde të subvencioneve dhe stimulujve. Kjo lloj politike industriale mund të ketë qenë e zakonshme në vende të caktuara – Japoni dhe disa vende europiane – pasi ka qenë e përshtatshme për të trajtuar problemin e tyre të vetëm, përballimin e kostove të kërkim-zhvillimit. Por, për një vend si Shqipëria, problemi është më kompleks dhe trajtimi duhet të jetë i ndryshëm. Pra, politika jonë industriale duhet të fokusohet shumë më pak në stimujt nga lart-poshtë dhe shumë më tepër në krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm midis sektorit publik dhe privat rreth çështjeve të produktivitetit dhe qëllimeve shoqërore.

Së treti, “politika industriale nuk mund të jetë më një

politikë e izoluar, e zhvilluar më vete dhe në kundërshtim me politikat e konkurrueshmërisë, me politikat rajonale dhe me politikat e tjera të rritjes” (Aiginger, 2014). Politika e konkurrueshmërisë synon kryesisht mirëqenien e konsumatorit, ndërsa politika industriale ka të bëjë me zhvillimin industrial dhe është shumë më dinamike. Në planin afatgjatë, të dyja qëllimet duhet të jenë të qëndrueshme, por në afat të shkurtër, maksimizimi i përfitimeve të konsumatorit mund të çojë në përparësi të ndryshme nga diversifikimi dhe dinamizmi produktiv që kërkon politika industriale.

Së katërti, mbështetja për ndryshimin strukturor dhe rritjen e produktivitetit duhet të marrë parasysh drejtimin e ndryshimit teknologjik. Në ekonominë në zhvillim, diskutohet nëse politika industriale duhet të synojë drejt kopjimit të strategjive të ndjekura nga “ekonomitë kryesore” apo do të ishte më mirë të kërkonte një qasje më të përshtatshme për vendin dhe fazën e zhvillimit të tij. Nëse Shqipëria vazhdon të ndjekë rrugën që kanë përshkuar vendet në zhvillim, do të jetë e vështirë t’i arrijë apo t’i kalojë lehtë ato. Ky quhet paradoksi “i Arritjes”. Me fjalë të tjera, një ekonomi më inferiore nuk mund të mundë apo të konkurrojë një ekonomi të përparuar nëse lufton duke përdorur të njëjtat armë ose strategji, as duke ndjekur të njëjtën rrugë. Prandaj, vendet në zhvillim duhet të gjejnë një rrugë alternative për t’u çliruar nga rraskapitja që shkakton paradoksi i arritjes së vendeve më të përparuara.

7

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Pas promovimit të Konsensusit neoliberal të Uashingtonit, i cili, pas vitit 1980 u bë rryma kryesore e zhvillimit ekonomik, politikat industriale u anashkaluan. Por ekonomitë e suksesshme, duke përfshirë edhe “djepin” e Konsensusit të Uashingtonit, SHBA-në, gjithmonë janë mbështetur në ndërhyrjet aktive të qeverisë për të përshpejtuar rritjen dhe transformimin strukturor. Po të gërvishtim sipërfaqen e çdo industrie të re të suksesshme kudo në botë, do të gjejmë ndihmën e qeverisë të fshehur nën të.

Politikëbërësit e shekullit XXI duhet të kuptojnë se politika industriale moderne që kërkon zhvillimi në epokën që po jetojmë është ndryshe nga politikat e vjetra industriale që janë promovuar gjatë viteve 1960–1980. Ato sot duhet të trajtojnë nevojën për të ushqyer dhe për të zhvilluar aktivitete të sofistikuara ekonomike, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm te prodhimi. Qëllimi i tyre kryesor është të rritin produktivitetin nëpërmjet inovacionit dhe si të tilla ato do t'i siguronin ekonomisë sonë virtytin që i mungon, “aftësinë për inovacion”. Është pikërisht mungesa e aftësive për inovacion, arsyeja që ka ngushtuar shtegun e zhvillimit ekonomik shqiptar. Karakteristikat e ekonomisë shqiptare qartazi tregojnë se ajo ka rënë në kurthin e të ardhurave të mesme. KAM-i është simptoma e dështimit për t'u transformuar nga ekonomi me të ardhura të mesme në ekonomi me të ardhura të larta, për shkak të mungesës së eksporteve të produkteve dhe shërbimeve të sofistikuara. Prodhimi i të njëjtit grup mallrash ose kryerja e të njëjtit grup detyrash çoi me shpejtësi në stanjacion apo më keq, në pakësim të produktivitetit në Shqipëri.

Për të dalë nga ky kurth, Shqipërisë i duhet të ndryshojë qasjen strategjike të zhvillimit. Nëse deri tani ka ecur me marshin më të ulët, atë “të zvarritjes së kërmillit”, sot ajo duhet të tentojë marshin e dytë, “atë të kërcimit të gjatë”, i cili konsiston jo vetëm në përmirësimin e sektorëve ku kemi shfaqur avantazh konkurrues, por edhe në identifikimin e më pas zhvillimin e sektorëve të rinj, të cilët janë dinamikë, për shkak të kërkesës së tyre në rritje në tregjet globale, duke përmirësuar gjithë strukturën ekonomike.

Në këndvështrimin tonë, ne rekomandojmë që procesi i identifikimit të përqendrohet te sektorët që kanë barriera të ulëta të hyrjes. Është e ditur tanimë që barriera të ulëta hyrjeje kanë sektorët që bazohen në burime natyrore, sektorë për të cilët një vend a priori ka edhe avantazh konkurrues. Po kështu, barriera të ulëta paraqesin sektorët me cikël të

shkurtër teknologjik, të cilët karakterizohen nga: mungesa e përplasjeve me teknologjitë e vendeve të përparuara, më pak mosmarrëveshje për pronësinë intelektuale, më pak pagesa rente për pronësinë intelektuale, starti i njëjtë për të gjitha vendet, dhe diferencimi i produktit.

Megjithëse qëllimi i punimit nuk ishte identifikimi i sektorëve, energjinë e gjelbër, buqësinë inteligjente apo teknologjinë e regjistrit të shpërndarë, i sugjerojmë si sektorë për eksplorim të mëtejshëm, ndërkohë që përputhen edhe me interesin strategjik të shprehur nga Qeveria.

Përtej identifikimit të sektorëve që mund të mbështetin në afat të gjatë rritjen ekonomike, një politikë industriale e suksesshme duhet të fokusohet te rritja e aftësive inovative të firmave vendase, të cilat sot janë jo vetëm të paafta për inovacion, por edhe shumë të fragmentarizuara. Është e domosdoshme t'u ofrojmë atyre “mundësi për të mësuar, në mënyrë që të rritin aftësitë e tyre inovative”. Për të realizuar këtë, është e nevojshme ngritja e Sistemeve Kombëtare të Inovacionit. Strategjitë qeveritare sot bazohen te modeli linear i inovacionit, i cili thekson rolin e njohurive shkencore si një input për inovacionin industrial. Por njohuritë shkencore vështirë të transformohen në njohuri teknologjike kur mungojnë sistemet efektive ose të zhvilluara sa duhet të inovacionit, të cilat mundësojnë transformimin dhe shpërndarjen e njohurive.

Dhe e fundit, por më jo më pak e rëndësishmja, stimujt fiskalë të përdorur deri tani nuk nxitin kërkim-zhvillimin dhe inovacionin. Për zhvillimin e njohurive dhe të teknologjive vendase, njohuritë e huaja janë kritike, pasi, pa njohuritë e huaja, përpjekja e vendeve në zhvillim shpesh bëhet e rrezikshme, kërkon kohë dhe është e kushtueshme. Aksesimi i tyre duhet të mundësohet nga qeveria. Financimi i eksternaliteteve që lidhen me kërkim-zhvillimin në sektorët pionierë është po ashtu i rëndësishëm. Por gjithsesi stimujt duhet të jenë gjithmonë të kufizuar në kohë dhe në sasi, duke kufizuar kështu mundësinë për kapjen e shtetit dhe krijimin e monopoleve.

Sipas Dani Rodrik-ut, “politika industriale, më shumë se një listë politikash, është një mënyrë të menduari”. Ajo nuk është gjë tjetër veçse procesi i përzgjedhjes së studentëve të mirë (sektorëve), afrimi i tyre me mësues të mirë (sistemet kombëtare) dhe përbalimi i shpenzimeve që ata të ndjekin shkolla të shkëlqyera (subvencionimi për kërkim-zhvillim).

BIBLIOGRAFIA:

- Allen Dennis dhe Ben Shepherd:** *Kostot e tregtisë, barrierat e hyrjes dhe diversifikimi i eksportit në vendet në zhvillim.* Nr. 4368, Seria e dokumenteve të kërkimeve politike nga Banka Botërore.
- Amurgo-Pacheco, Alberto; Pierola, Martha Denisse** (2008): *Modelet e diversifikimit të eksportit në vendet në zhvillim: Margjina intensive dhe të gjera.* Banka Botërore.
- Ana Cristina Molina dhe Marco Fugazza** (2009): *Përcaktuesit e mbijetesës tregtare.* Punime të IHEI-së. Seksioni i Ekonomisë, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare.
- Annamaria Castrignano, Gabriele Buttafuoco, Raj Khosla, Dimitrios Moshou, Abdul Mouazen, Olivier Naud** (Elsevier 2020): *Interneti i Objekteve në Bujqësi dhe mbështetja e vendimeve për Bujqësinë Inteligjente.*
- Augustin Kwasi Fosu** (shkurt 1990): *Eksportet dhe rritja ekonomike: Rasti afrikan.* Zhvillimi botëror.
- Banka Botërore** (2005): *Rritja ekonomike në vitet 1990: Mësimi nga një dekadë reformash.*
- Banka Botërore,** (2009): *Shqipëria, Ndërtimi i konkurrenshëmrisë në Shqipëri; Raste studimesh sektoriale: Veshmbathje dhe këpucë, turizëm, miniera.*
- Banka Botërore.** (2010): *Eksplorimi i kurthit të të ardhurave të mesme.*
- Banka Botërore** (2019): *Zhbllkimi i rritjes së punësimit përmes produktivitetit. Diagnostikimi i Shqipërisë në nivel firme.*
- Banka Botërore** (vite të ndryshme): *Treguesit e Zhvillimit Botëror (WDI).*
- Banka Botërore** (2002, 2004): *Rishikim i aktiviteteve të biznesit të vogël.*
- Barry Eichengreen, Parku Donghyun, Kwanho Shin** (janar 2013): *Ngadalësimi i rritjes: Evidenca të reja të kurthit të të ardhurave të mesme.*
- Ben Ramalingam** (2013): *Ndihma në fillim të kaosit. Rimendimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në një botë komplekse.*
- Bent Dalum, Keld Laursen, Gert Villumsen** (shkurt 1998): *Ndryshimi strukturor në modelet e specializimit të eksportit të OECD-së: Despecializimi dhe "Ngjitshmëria". Rishikimi ndërkombëtar i ekonomisë së aplikuar.*
- C. A. Hidalgo, B. Klinger A.-L. Barabási, R. Hausmann** (27 korrik 2007): *Hapësira e produktit kushtëzohet zhvillimin e kombeve.* Shkenca: vëll. 317, çështja 5837.
- Carkovic, M. V., dhe Levine, R. Universiteti i Minesotës** (2002): *A e përshpejton rritjen ekonomike investimet e huaja direkte? Universiteti i Minesotës, Departamenti i Financës.*
- Cheng Hsiao dhe Yan Shen** (2003): *Investimet e Huaja Direkte dhe zhvillimi ekonomik: Rëndësia e institucioneve dhe urbanizimi.* Zhvillimi ekonomik dhe ndryshimi kulturor, vëll. 51, nr. 4.
- D. Rosenblatt** (2013): *Kurthi i të ardhurave të mesme: Një studim konceptual dhe empirik.* Dokument pune i Bankës Botërore.
- Dani Rodrik** (1996): *Kuptimi i reformës së politikës ekonomike.* Gazeta e literaturës ekonomike, vëll. 34, nr. 1.
- Dani Rodrik** (2006): *Mirupafshim, Konsensus i Uashingtonit, përshëndetje, Konfuzion i Uashingtonit? Një rishikim i rritjes ekonomike në vitet 1990 nga Banka Botërore: Mësimi nga Dekada e Reformës.* Gazeta e literaturës ekonomike, vëll. 44, nr. 4.
- Dieter Ernst, Linsu Kim** (2007): *Rrjetet e Prodhimit Global, Shpërndarja e njohurive dhe formimi i kapaciteteve lokale.* Politikë kërkimore.
- Edward L. Glaeser, Rafael La Porta, Florencio Lopez-de-Silanes dhe Andrei Shleifer** (2004): *A ndikojnë institucionet te rritja? Gazeta e rritjes ekonomike, vëll. 4.*
- Elemente të strategjisë** (2010): *Një politikë industriale për epokën e globalizimit.*
- Gill, Indermit; Kharas, Homi** (2007): *Një rilindje e Azisë Lindore. Ide për rritjen ekonomike.* Banka Botërore.
- Hallward-Driemeier, Mary; Nayar, Gaurav** (2017): *Probleme me inovacionin? E ardhmja e zhvillimit të udhëhequr nga prodhimi.* Banka Botërore.
- ILO** (2016): *Azia në transformim: Si po i ndryshon teknologjia punësimin dhe ndërmarrjet.*
- J. Benson Durham** (2004): *Kapaciteti absorbues dhe efektet e investimeve të huaja direkte në rritjen ekonomike.* Revista ekonomike europiane, vëll. 48, nr. 2.
- John Weiss** (2002): *Industrializimi dhe globalizimi: Teori dhe dëshmi nga vendet në zhvillim.*
- Joseph Stiglitz dhe Bruce Greenwald** (2014): *Krijimi i një shoqërie që mëson: Një qasje e re ndaj rritjes, zhvillimit dhe përparimit social.*
- Keun Lee dhe Byung-Yeon Kim** (2009): *Si institucionet, ashtu edhe politikat kanë rëndësi, por janë të ndryshme për grupe të ndryshme të nivelit të të ardhurave: Përcaktuesit e rritjes ekonomike afatgjatë të rishikuar.* Zhvillimi botëror, vëll. 37, nr. 3.
- Keun Lee** (2019): *Arti i arritjes ekonomike: Barrierat, devijimet dhe tejkalimet në sistemet e inovacionit.*
- Laura Alfaro, C.A. Kalemli-Ozcan, S. Sayek** (janar 2004): *IHD-të dhe rritja ekonomike: Roli i tregjeve financiare lokale.* Gazeta e ekonomisë ndërkombëtare.
- Lin, Justin Yifu; Monga, Celestin** (2010): *Identifikimi dhe lehtësimi i rritjes. Roli i Shtetit në dinamikën e ndryshimit strukturor.* Dokument pune për hulumtimin e politikave; Banka Botërore.
- Lizabeth Navas-Alemán** (2011): *Ndikimi i operimit në zinxhirë të shumëfishit vlerash për zhvillimin: Rasti i industrive braziliane të mobiljeve dhe këpucëve.* Instituti i Studimeve të Zhvillimit, Brighton, MB.
- Mariana Mazzucato** (2013): *Shteti sipërmarrës: Zhbërja e mitit publik kundrejt sektorit privat.*
- Mark Granovetter** (1995): *Rast i rishikuar: Grupet e biznesit në ekonominë moderne.* Ndryshimet industriale dhe korporative, vëll. 4, nr. 1.
- Nadia Doytch dhe Uctum** (2011): *A e përshpejton rritjen ekonomike zhvendosja mbarëbotërore e IHD-ve nga prodhimi në shërbime? Një studim vlerësimi.* Gazeta e parave dhe financave ndërkombëtare, vëll. 30, nr. 3.

Niels Hermes dhe Robert Lensink (2003): *Investimet e huaja direkte, zhvillimi financiar dhe rritja ekonomike*. Gazeta e studimeve të zhvillimit, vëll. 40, nr. 1.

OECD (2013): *Perspektiva e zhvillimit global. Politikat industriale në një botë në ndryshim*.

OECD (2019): *Europa globale Juglindore: Çlirimi i potencialit të transformimit për rritje në Ballkanin Lindor*.

Paul Brenton, Christian Saborowski, Erik von Uexkull (2010): *Çfarë shpjegon shkalla e mbijetesës dhe fluksi i ulët i eksporteve të vendit në zhvillim? Rishikimi ekonomik i Bankës Botërore*, vëll 24, çështja nr. 3.

Plumper, T, Graff, M. (2001): *Specializimi i eksportit dhe rritja ekonomike*. Revista e ekonomisë politike ndërkombëtare, nr. 8.

Rabah Arezki, Reda Cherif, John Piotrowski (gusht 2009): *Specializimi i turizmit dhe zhvillimi ekonomik: Dëshmi nga lista e trashëgimisë botërore të UNESCO-s*. Punim i FMN-së, nr. 09/176.

Reda Cherif dhe Fuad Hasanov (2019): *Kthimi i politikës që nuk duhet emërtuar: Parimet e politikës industriale*. Dokument pune i FMN-së.

Ricardo Hausmann, Jason Hwang, Dani Rodrik (mars 2007): *Çfarë rëndësie ka eksporti? Gazeta e rritjes ekonomike*, Springer, vëll. 12 (1).

Ricardo Housmann, Cesar Hidalgo (korrik 2009): *Bloqet ndërtuese të kompleksitetit ekonomik*. Punimet e Akademisë Kombëtare të Shkencave.

Samuel Adams (2009): *Investimet e huaja direkte, investimet e brendshme dhe rritja ekonomike në Afrikën Sub-Sahariane*. Gazeta e modelimit të politikave, vëll. 31, nr. 6.

Sir David Greenaway Robert C. Hine and Peter Wright (1999): *Një vlerësim empirik i ndikimit të tregtisë në punësim në Mbretërinë e Bashkuar*. Gazeta europiane e ekonomisë politike, vëll. 15, nr. 3.

Shiva S. Makki, Agapi Somwaru (2004): *Ndikimi i Investimeve të Huaja Direkte dhe tregtisë në zhvillimin ekonomik: Dëshmi nga vendet në zhvillim*. Gazeta amerikane e ekonomisë bujqësore vëll. 86, nr. 3.

Tibor Besedeš Thomas J. Prusa (janar 2006): *Hyrjet dhe daljet dhe kohëzgjatja e tregtisë*. Gazeta kanadeze e ekonomisë.

Tim O'Brein, Ljubica Nedelkoska, Ermal Frashëri (2014): *Çfarë e pengon rritjen në Shqipëri? Qendra e Zhvillimit Ndërkombëtar në Universitetin e Harvardit*.

UNCTAD dhe ILO (2014): *Politikat industriale në një ekonomi në ndryshim në një botë që transformohet: Krijimi i politikave industriale për rritje, punësim dhe zhvillim*.

UNIDO (2014): *Një metodologji e propozuar për vlerësimin e qëndrueshëm të nënsektorëve industrialë për këshilla mbi politikat*.

V. N. Balasubramanyam, M. Salisu dhe David Sapsford (janar 1996): *Investimet e Huaja Direkte dhe Rritja*. The Economic Journal., vëll. 106, nr. 434.

Volker Nitsch (2009): *Vdis një ditë tjetër: kohëzgjatja në tregtinë e importit gjerman*. Review of World Economics, vëll. 145.

Wade, R. H. (2003): *Cilat strategji janë të zbatueshme për vendet në zhvillim sot? Organizata Botërore e Tregtisë dhe turrja e "Hapësirës së zhvillimit"*. Review of International Political Economy, 10 (4).

Wade, R. H. (2012): *Kthimi i politikës industriale? International Review of Applied Economics*, 26.

MBI AUTORËT

Irena Beqiraj, CFA

Irena Beqiraj është diplomuar për Financë në Universitetin e Tiranës dhe mban dy tituj profesionalë: titullin ndërkombëtar “Charter Financial Analyst” (CFA) dhe titullin “Kontabilist i Miratuar”. Nga dhjetori 2014 deri në tetor 2017, ka shërbyer në poste, si Zëvendësministre e Financave, Këshilltare pranë zyrës së Kryeministrit dhe Drejtoreshë e Deleguar e Doganave.

Znj. Beqiraj ka një eksperiencë të gjatë pune në institucione financiare kombëtare dhe ndërkombëtare në hartimin e politikave publike, taksimit e planifikimit strategjik, menaxhimit ekzekutiv, qeverisjes dhe sistemeve rregullatore të institucioneve publike. Ajo ka gjithashtu një eksperiencë të spikatur akademike, e cila fillon që prej vitit 1998, ku ka punuar si pedagoge pranë Fakultetit të Ekonomisë, Dega Financë.

Knidi Bashari, MPA

Knidi Bashari është diplomuar në Universitetin e Tiranës dhe mban titullin Master në Administrim Publik nga programi i përbashkët i Universitetit të Nebraskës, SHBA me Universitetin e Tiranës. Z. Bashari ka një eksperiencë të gjatë në fushën e financave dhe të ekonomisë, duke shërbyer si këshilltar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë në periudhën 2002–2004 dhe 2015–2019. Në këtë funksion, ai ka mbuluar çështje që lidhen me marrëdhëniet dhe projektet e institucioneve ndërkombëtare, duke përfshirë Bankën Botërore, FMN-në, IFC-në dhe EBRD-në, politikat e buxhetit të shtetit dhe investimet publike, analizat e të ardhurave dhe politikat fiskale. Z. Bashari ka një përvojë të gjatë në shërbime këshillimore dhe kërkimore mbi projektet e zhvillimit, projeksionet makroekonomike, projektet ndërkombëtare dhe mbështetjen e institucioneve, duke shërbyer si konsulent për një sërë organizatash ndërkombëtare, institucione qeveritare dhe kompani private, si Delegacioni European në Shqipëri, IFC-ja, IOM-i, KGH Global Services, IBF International Consulting, IDRA Research and Consulting, GIZ-i dhe Friedrich-Ebert-Stiftung në Shqipëri.

IMPRINT

Fondacioni “Friedrich Ebert” | Rr. “Kajo Karafili”, Nd. 14, Hyrja 2, Kati 1 | Tiranë | Shqipëri

Përgjegjës:

Stine Klapper | Drejtoreshë e Fondacionit “Friedrich Ebert”, Zyra e Tiranës

Tel: +355 4 22 509 86 / 733 06

<https://tirana.fes.de/>

Menaxhere Programi:

Jonida Smaja

Redaktore letrare:

Edlira Shuli

Përdorimi tregtar i të gjitha materialeve mediatike të publikuara nga Fondacioni «Friedrich-Ebert» (FES) nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të FES-it.

SHTEGU I NGUSHTË I ZHVILLIMIT

Koha për politika industriale



Ky punim synon të përcaktojë dhe të analizojë përbërësit e një politike industriale të suksesshme për Shqipërinë, si dhe sugjeron disa konsiderata se si një politikë industriale duhet t'i përshtatet kornizës së gjerë të politikëbërjes.

Më hollësisht, autorët janë përpjekur të shpjegojnë përse politika indus-



triale ka dalë sërish në skenë, megjithëse eksperiencia e vendeve të zhvilluara tregon se, edhe pse është anashkaluar, ajo nuk ka qenë kurrë jashtë skene; të analizojnë rrugën e ndjekur drejt rritjes së qëndrueshme, dhe përse vendet në zhvillim ngecin në "kurthin e të ardhurave të mesme", cilët janë faktorët që drejtojnë rritjen në këtë fazë dhe cili është variabli



kryesor i rritjes afatgjatë që mundëson kalimin në shtegun e ngushtuar tanimë të zhvillimit; të ekzaminojnë karakteristikat e ekonomisë shqiptare, duke vënë theksin te dy dështimet kryesore të saj: dështimin për të krijuar aftësi inovative në nivel firme, si dhe mungesën e ekonomisë së shkallës, apo dështimin strukturor të madhësisë së biznesit.

Për më shumë informacion:
<https://www.tirana.fes.de/al/publikime/>